



Kingdom of the Netherlands

Kontributi dhe sfidat e Shoqërisë Civile në Shqipëri

Dokument Qëndrimesh

Tetor, 2024

Ky publikim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, “Përmirësimi i Debatit mbi Politikat dhe Llogaridhënien për të Përbushur të Drejtat Bazike, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri”, zbatuar nga katër organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Studimet Politike dhe Instituti Shqiptar i Shkencës, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese.

Hartoi:

- Elona Dhëmbo, Eksperte e Jashtme, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rishikoi:

- Z. Njazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- Znj. Teuta Pataj, Paraligjore/Asistente Projektsh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor:

©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752, Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al

Website: www.ahc.org.al

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtesa.....	3
Përmbledhje ekzekutive	4
Sfondi	6
Metodologjia.....	8
Kuadri ligjor dhe institucional për SHC në Shqipëri	9
Problematika të mbartura të ShC në Shqipëri & Raporti i Komisionit European, 2023	12
Perceptime mbi zvogëlimin e hapësirës së ShC-së dhe shkaqeve nga aktorët lokalë	15
1. Të përcaktosh dhe masësh hapësirën e Shoqërisë civile.....	15
2. Çdo gjë nis nga imazhi – imazhi i ShC dhe roli i medias	17
3. Përtej imazhit - perceptime dhe dëshmi mbi ngushtimin e hapësirave për ShC.....	19
3.1. Tendenca të përgjithshme.....	19
3.2. sfida të kuadrit ligjor, rregullator e operacional	20
3.3. “Gjërat në letër nuk mjaftojnë!” – mungesa e burimeve dhe qartësive në ndarjen e roleve dhe përgjegjësi.....	22
3.4. (Mos)Përfshirja e ShC në Procese Politikëbërje dhe të integritimit në BE	23
4. Mjedisi financiar	25
4.1. Financimi i ShC.....	25
4.2. Taksimi i ShC.....	27
4.3. Roli i donatorëve	28
5. Problematika dhe sfida të tjera.....	29
5.1. Konkurrenca e padrejtë dhe korrupsioni i vetë sektorit	29
5.2. Krizat dhe zvogëlimi i mbështetjes	31
6. E ardhmja e Afërt – mundësi dhe rreziqe.....	31
Përfundime dhe rekomandime	34
Referenca	38

SHKURTESA

AKR – Agjencia Kombëtare e Rinisë

AMShC – Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

BE – Bashkimi European

FG – Fokus grup

II – Intervistë individuale

KE – Komisioni European

KKShC – Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

KShH – Komiteti Shqiptar i Helsinkit

MShMS – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

OShC – Organizatë e Shoqërisë Civile

ShC – Shoqëri Civile

TVSh – Tatim mbi Vlerën e Shtuar

QSh – Qeveria e Shqipërisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në të gjithë botën, shqetësimet për funksionalitetin e demokracive përfaqësuese kanë ardhur në rritje, kryesisht në raport me pamjaftueshmërinë e përfaqësimit, duke bërë që studiues dhe ekspertë të kërkojnë kompensim për mes demokracisë pjesëmarrëse ku gjithë-përfshirja dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procese politikë-bërëse dhe vendim-marrëse janë kryefjala. Demokracia përfaqësuese ka potencialin të ndikojë si në aspektet demokratike, ashtu edhe në ato teknike të proceseve qeverisëse. Ajo, jo vetëm mundëson më shumë demokraci ‘thelbësore’, duke i lejuar qytetarëve të kenë një zë të vazhdueshëm, e jo vetëm në kohë zgjedhjesh, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë civile (ShC), e cila është esenciale për vende që janë duke pësuar transformime demokratike, që kanë tendenca autokratike, apo ato ku situata e etikës publike, llogaridhënies, transparencës, korrupsionit dhe mirëqeverisjes është shqetësuese.

Spektori i shoqërisë civile në Shqipëri ka evoluar ndjeshëm që nga fillimi i viteve '90-të, por, pavarësisht progresit, ShC në Shqipëri përballet me sfida të vazhdueshme që ndikojnë në efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe perceptimin e publikut. Qeveria e Shqipërisë (QSh) ka treguar se ka vullnetin për të konsideruar dhe përfshirë ShC-në në përpjekjet për qeverisje (më) të mirë dhe rezultate të qëndrueshme, kjo konkretizuar në dokumente politike si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015–2021, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, ashtu edhe me dokumente të dedikuara për mjedisin për ShC si “Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023”. Përtej vullnetit, përpjekjet dhe rezultatet e arritura kanë qenë të kufizuara dhe pak të dokumentuara. Vlerësime të deritanishme nga aktorë ndërkombëtarë (si p.sh. Raporti *Screening* i KE 2023) dhe kombëtarë (si p.sh. Matrica Për shoqërinë Civile 2022 nga Partners Albania, 2023) pikturojnë një panoramë larg objektivave të vendura në Udhërrëfyes dhe ngrënë shqetësime për një tendencë tkurrjeje të hapësirës dhe rolit të shoqërisë civile. Në këtë kontekst, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), me mbështetjen e Ambasadës së Vendeve të Ulëta në Tiranë, ndërmorën hartimin e këtij dokumenti politikash, duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës ashtu edhe në të dhëna parësore të mbledhura përmes intervistave dhe fokusgrupeve me përfaqësues nga aktorët kryesorë.

Gjetjet konfirmojnë shqetësimet që lidhen me perceptimin e një ngushtimi të hapësirës apo të një mjedisi jo mjaftueshëm mundësues për shoqërinë civile në vend. Edhe pse ende nuk ka një raport vlerësimi mbi arritjet në hapësirën e veprimit të Udhërrëfyesit për ShC, zbatimi i masave të parashikuara për të krijuar një mjedis të mundësues për shoqërinë civile ka qenë i pamjaftueshëm dhe kërkon përpjekje shtesë, burime dhe monitorim të përmirësuar. Një sërë problematikash kanë vijuar të mbarten në kohë, pa marrë vëmendjen e domosdoshme për adresim ose pa arritur rezultate të qëndrueshme. Çështjet e zbatimit dhe funksionalitetit të kuadrit ligjor për ShC mbeten ende problematike dhe efektshmëria e proceseve të konsultimit e kufizuar, ndër të tjera si pasoj e aksesit të dobët dhe transparencës së ulët.



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Mbështetja institucionale për ShC mbetet e dobët dhe roli i Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) ende marginal. Mjedisi financiar ka parë vetëm përmirësime të vogla në termat e parave publike të shtuara në mbështetje të ShC, por financimi publik mbetet i pamjaftueshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e OShC-ve, veçanërisht në rolet e ofruesve të shërbimeve. Regjimi tatimor është i pafavorshëm, i mungojnë stimujt për donacione dhe imponon procese komplekse të rimbursimit të TVSH-së.

Një përkeqësim i gjuhës të përdorur në raport me ShC, atakimit të vazhdueshëm të saj apo aktorëve të veçantë, si dhe problematika të imazhit, konkurrencës dhe korrupsionit brenda sektorit shtojnë sfidat për ShC dhe adresimin e problematikave të identifikuara dhe të nënvizuara edhe nga Raporti i Komisionit European për 2023.

Në raport me këto konstatime, një sërë rekomandimesh u shqyrtuan dhe validuan edhe me aktorët e përfshirë në procesin e hartimit të këtij dokumenti. Ato paraqiten në fund të këtij dokumenti duke targetuar katër kategori kryesore aktorësh: aktorët përgjegjës për ligj- dhe politikë-bërje në vend si dhe për mundësimin e zbatueshmërisë së tyre, komunitetit të aktorëve ndërkombëtarë dhe donatorëve, vetë organizatave të ShC, si dhe medias.

SFONDI

Që nga mesi i shekullit të kaluar, kritikën mbi demokracitë përfaqësuese¹ moderne kanë ardhur në rritje.² Shqetësimi kryesor lidhet me pamjaftueshmërinë e përfaqësimit, qoftë si koncept apo sistem ashtu edhe në praktikë.³ Është vërejtur se “përfaqësuesit”, pra të zgjedhurit në demokracitë përfaqësuese, më shumë sesa si “zëri” i njerëzve që i kanë zgjedhur ata, veprojnë “thjesht në vend të tyre”⁴, duke krijuar hendeqe midis vullnetit të elektoratit dhe veprimeve të ndërmarra nga politikanët e zgjedhur. Adresimin e këtyre mangësive dhe problematikave, studiuës të shumtë e kanë parë të mundur vetëm përmes demokracisë pjesëmarrëse.⁵ Kështu që nga fillimi i viteve 2000, gjithë-përfshirja dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procese politikë-bërëse dhe vendim-marrëse janë kthyer në një kryefjalë dhe pritshmëri thujtë standarde në vendet demokratike.⁶

Demokracia përfaqësuese ka potencialin të ndikojë si në aspektet demokratike, ashtu edhe në ato teknike të proceseve qeverisëse. Ajo, jo vetëm mundëson më shumë demokraci ‘thelbësore’, duke i lejuar qytetarëve të kenë një zë të vazhdueshëm, e jo vetëm në kohë zgjedhjesh, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë civile (ShC).⁷ Kjo vlen edhe më shumë për vende që janë duke pësuar transformime demokratike,⁸ që kanë tendenca autokratike,⁹ apo ato ku situata e etikës publike, llogaridhënies, transparencës, korrupsionit dhe mirëqeverisjes është

¹ Demokracia Përfaqësuese është një sistem ku qytetarët zgjedhin përfaqësuesit për të marrë vendime në emër të tyre. Në këtë model, zyrtarët e zgjedhur kanë për detyrë të pasqyrojnë vullnetin e popullit dhe të bëjnë zgjedhje legjislative ose politike në interesin më të mirë të zgjedhësve të tyre.

² Arnstein, S. R. (1969). A ladder of citizen participation. *Journal of the American Planners*, 35(4), 216–224.; Pateman, C. (1970). *Participation and democratic theory*. Cambridge: Cambridge University Press.

³ Shiko për më shumë: Radzik-Maruszak, K., Haveri, A., & Pawłowska, A. (2020). Pro-civic representation? Citizens’ participation in the opinion of Finnish and Polish local councilors. *Transylvanian Review of Administrative Sciences**, (60E), 85–103. <https://doi.org/10.24193/tras.60E.6>.

⁴ Pitkin, H. F. (2004). Representation and democracy: Uneasy alliance. *Scandinavian Political Studies*, 27(3), 335–342., f. 339

⁵ Demokracia Pjesëmarrëse është një sistem ku qytetarët kanë përfshirje të drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse. Kjo qasje mundëson angazhimin aktiv të qytetarëve, shpesh përmes mekanizmave si forumet publike, referendumet ose strukturat vendimmarrëse të bazuara në komunitet, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet në formësimin e politikave dhe ligjeve.

⁶ Shiko për një përmbledhje Quick, K. S., & Bryson, J. M. (2016). Public participation. In C. Ansell & J. Torfing (Eds.), *Handbook on theories of governance* (pp. 158–169). London: Edward Elgar., f. 159

⁷ Geurtz, C., & Van de Wijdeven, T. (2010). Making citizen participation work: The challenging search for new forms of local democracy in the Netherlands. *Local Government Studies*, 36(4), 531–549. fq. 533

⁸ Baba, C., Cherecheș, R., Mora, C., & Țiclău, T. (2009). Public participation in public policy process – Case study in seven counties from North-Western region of Romania. *Transylvanian Review of Administrative Sciences*, 26E, 5–13. f. 5-13

⁹ Freedom House (2024), NATIONS IN TRANSIT 2024, https://freedomhouse.org/sites/default/files/2024-04/NIT_2024_Digital_Booklet.pdf, f.10 (aksesuar 21 korrik 2024).

shqetësuese.¹⁰ Në këto kontekste, pjesëmarrja qytetare është një tipar kyç i (vullnetit për) qeverisjes së mirë.

Sektori i shoqërisë civile në Shqipëri ka evoluar ndjeshëm që nga fillimi i viteve 1990, duke kaluar nga thjesht një grup organizatash në fillim, në një pjesë më të strukturuar dhe më me ndikim në peizazhin socio-politik të vendit.¹¹ Ky evolucion pasqyron tranzicionin më të gjerë politik dhe ekonomik të Shqipërisë, teksa vendi kaloi nga një regjim komunist në një shoqëri demokratike. Megjithatë, pavarësisht progresit, shoqëria civile në Shqipëri përballet me sfida të vazhdueshme që ndikojnë në efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe perceptimin e publikut.¹² Pavarësisht rritjes në numër dhe profesionalizëm, si dhe zgjerimit të ndikimit të tyre në fusha të ndryshme¹³, duke përfshirë advokimin e politikave, llogaridhënien publike dhe ofrimin e shërbimeve, sektori manifeston sfida dhe pabarazi në kapacitete, ndikim dhe stabilitet financiar midis organizatave të ndryshme.¹⁴

Qeveria e Shqipërisë (QSh) ka treguar se ka vullnetin për të konsideruar dhe përfshirë ShC-në në përpjekjet për qeverisje (më) të mirë dhe rezultate të qëndrueshme. Përmes dokumenteve zyrtare, QSh është e angazhuar ta përfshijë aktivisht ShC-në në përcaktimin e agjendës politike të vendit, si dhe në zbatimin e politikave të monitorimit, sidomos në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian (BE). Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015–2021¹⁵, si dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian¹⁶ theksojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë

¹⁰ Council of Europe (2020) GEORGIA Handbook on Transparency and Citizen Participation

¹¹ Dhëmbo, E. (2017). “Albania” in Civil Society in Central and Eastern Europe: Challenges and Opportunities Edited by Peter Vador, Nicole Traxler, Reinhard Millner, and Michael Meyer, ERSTE Stiftung Studies, Vienna, Austria. ISBN 978-3-902673-10-7, https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil_society_studie_issuu_e1-1.pdf

¹² Dhëmbo, E. (2019). “Albania” in Civil Society in Central and Eastern Europe: Monitoring 2019 Editors: Eva More-Hollerweger, Flavia-Elvira Bogorin, Julia Litofcenko, Michael Meyer, ERSTE Foundation, Vienna, ISBN 978-3-902673-14-5 <https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil-society-in-central-and-eastern-europe-monitoring-2019-1.pdf>

¹³ Bino, B, Qirjazi, R., & Dafa, A. (2021). CSO PARTICIPATION IN DECISION-MAKING IN ALBANIA. Institute for Democracy and Mediation, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania-1.pdf>; Dhëmbo, E. (2019). “Albania” in Civil Society in Central and Eastern Europe: Monitoring 2019 Editors: Eva More-Hollerweger, Flavia-Elvira Bogorin, Julia Litofcenko, Michael Meyer, ERSTE Foundation, Vienna, ISBN 978-3-902673-14-5 <https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil-society-in-central-and-eastern-europe-monitoring-2019-1.pdf>

¹⁴ Partners Albania for Change and Development. (2023). MONITORING MATRIX ON ENABLING ENVIRONMENT FOR CSOS DEVELOPMENT: COUNTRY REPORT FOR ALBANIA 2022. <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2022/>; Partners Albania for Change and Development. (2019). Needs assessment report 2019. <https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/12/Need-Assessment-Report-2019.pdf>

¹⁵ Ministria e Mbrojtjes e RSH (2015), Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015–2020, https://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf

¹⁶ Ministria e Drejtësisë e RSH (2022), (2023). Plani kombëtar për integrimin evropian 2023–2025. <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/PLANI-KOMB%3%8BTAR-P%3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN-2023-2025.pdf>

civile në procesin e integrimit European të vendit. Sipas “Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023”¹⁷, nxitja aktive dhe gjithëpërfshirëse e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike, karakteristike për shoqëritë demokratike, mund të mundësohet përmes një kuadri adekuat ligjor dhe financiar.

“Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023” u miratua nga qeveria shqiptare në njohje të rolit të ShC në politikëbërjen dhe qeverisjen e mirë, si dhe nevojën në rritje për të përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e mjedisit për punën dhe zhvillimin e saj. Ky dokument strategjik u hartua për të lehtësuar dhe forcuar bashkëpunimin midis qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC), duke synuar të mbështesë aspiratat e Shqipërisë për integrimin në Bashkimin European dhe të përmirësojë kuadrin e demokracisë pjesëmarrëse. Ndonëse është komisionuar dhe është duke u finalizuar një vlerësim i dedikuar mbi zbatimin e udhërrëfyesit¹⁸, vlerësime të deritanishme nga aktorë ndërkombëtarë (si p.sh. Raporti Shqyrtues [Screening] i KE 2023¹⁹) dhe kombëtarë (si p.sh. Matrica Për shoqërinë Civile 2022 nga Partners Albania, 2023)²⁰ pikturojnë një panoramë larg objektiveve dhe ngrenë shqetësime për një tendencë kurrjeje të hapësirës dhe rolit të shoqërisë civile. Në këtë kontekst, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), me mbështetjen e Ambasadës së Vendeve të Ulëta në Tiranë, prezantojnë këtë dokument politikash i cili është rezultat i shqyrtimit të literaturës, mbledhjes dhe shqyrtimit të evidencave mbi sfidat e hasura nga aktorët kyç, si dhe të mundësive për ndryshime për një mjedis më mundësues për ShC-në në vend.

METODOLOGJIA

Ky dokument politikash është bazuar në rishikimin dhe analizën e raporteve dhe studimeve ekzistuese, rishikimin e kuadrit ligjor mbi ShC në Republikën e Shqipërisë, si dhe në mbledhjen, shqyrtimin dhe analizën e të dhënave parësore nga aktorë kyç.

Pikënisje e rëndësishme në këtë proces ishte dokumenti kyç mbi ecurinë e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European, Raporti Shqyrtues 2023. Bazuar në konstatimet e këtij raporti, u përcaktuan çështjet kryesore mbi të cilat u hulumtua më tej në raportet dhe literaturën në fushë, si dhe u ndërtuan instrumentet për mbledhjen e të dhënave parësore. Intervistat individuale

¹⁷ VENDIM Nr. 539, datë 25.7.2019, Për Miratimin e Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023”, I Rishikuar

¹⁸ Sipas informacionit nga informatorë kyç të intervistuar në kuadër të hartimit të këtij dokumenti.

¹⁹ European Commission (2023). Screening report - Albania, 20/07/2023. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

²⁰ Partners Albania. (2023). *Monitoring matrix on enabling environment for CSOs development: Country report for Albania 2022*. <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2022/>

(3) si dhe diskutimet në fokus-grupe (2), u realizuan me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucione dhe agjenci shtetërore (2), organizatave të shoqërisë civile (13) duke përfshirë ofruesit e shërbimeve dhe organizata të natyrës “*think-tank*”²¹, si dhe studiues, gazetarë dhe akademikë (5). Ato u fokusuan në çështjet e mëposhtme:

- Perceptimet mbi zvogëlimin e hapësirës së ShC në vend;
- Shkaqet e një mjedisi (pa)mundësues për ShC dhe OShC-të në vend;
- Efektet e perceptuara dhe ato të pritura;
- Sfidat dhe strategjitë përballuese;
- Mundësitë për përmirësim, përfshi ato që krijohen nga procesi i anëtarësimit në BE.

Këto tematika udhëhoqën edhe analizën e të dhënave si dhe u përdorën për strukturimin e paraqitjes së gjetjeve dhe diskutimeve në këtë dokument.

Pjesëmarrësit u informuan dhe dhanë pëlqimin e tyre për përdorimin e të dhënave me konfidencialitet. Për këtë, citimet e përdorura nga intervistat apo fokus grupet do të shoqërohen vetëm me informacion për tipologjinë e profilit të pjesëmarrësit/institucionit apo organizatës që ai/ajo përfaqëson.

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR SHC NË SHQIPËRI

Rëndësia e rolit të shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit të vendeve candidate për në BE është theksuar vazhdimisht nga BE-ja gjatë dy dekadave të fundit. Duke u mbështetur në mësimet e nxjerra nga raundet e mëparshme të zgjerimit të BE-së, është pranuar se reformat komplekse të lidhura me legjislacionin e BE-së nuk mund të jenë të qëndrueshme pa ekzistencën e një shoqërie civile aktive dhe të gjallë, e cila është në gjendje të mbajë qeverinë përgjegjëse për cilësinë e zbatimit të reformave të miratuara. Për të ndihmuar qeveritë e vendeve candidate në strukturimin e përpjekjeve të tyre drejt mbështetjes së një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile, DG NEAR i Komisionit European ka zhvilluar Udhëzues për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile 2021-2027.²²

²¹ Një “*think tank*” është një organizatë joqeveritare që fokusohet në kryerjen e kërkimeve, analizave dhe avokimit në fusha të ndryshme politikash, si ekonomia, çështjet sociale, qeverisja ose marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto organizata synojnë të ndikojnë në politikat publike, vendimmarrjen dhe opinionin publik duke ofruar njohuri të bazuara në të dhëna, rekomandime të ekspertëve dhe ide novatore. Organizatat *think-tank* shpesh angazhohen me qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe publikun për të formuar politika dhe për të promovuar debat të informuar mbi çështjet shoqërore të rëndësishme.

²² European Commission. (2021). *DG NEAR guidelines for EU support to civil society in the enlargement region, 2021–2027*. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/dg-near-guidelines-eu-support-civil-society-enlargement-region-2021-2027_en

Në Republikën e Shqipërisë, liria e organizimit garantohej me Kushtetutë në nenin 46 të saj. Kushtetuta gjithashtu parashikonte kufizim të kësaj lirie kur aktorët e përfshirë (si p.sh. organizata ose shoqata) 'ndjekin qëllime antikushtetuese'. Më tej është Ligji për organizatat jofitimprurëse i cili formëson kuadrin ligjor kryesor, rregullator të veprimtarisë së shoqërisë civile në vend. Ky ligj përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse. Ai gjithashtu ofron garanci kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të OSHC-ve, duke garantuar ushtrimin e veprimtarisë së tyre në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërore. Ligji përcakton se një OShC mund të shpërndahet me vendim të gjykatës.

Ligji për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, i miratuar në vitin 2021²³, përcakton si procesin për regjistrim të organizatave jofitimprurëse ashtu edhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre. Megjithatë puna e vazhdueshme për krijimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të organizatave jofitimprurëse të parashikuar nga ligji në fjalë, nuk është kurorëzuar ende me një produkt final operacional.²⁴ Është për t'u shënuar se gjatë vitit 2023, Gjykata Kushtetuese, me kërkesë të një grupi OShC-sh²⁵, ka marrë në shqyrtim dhe ka shfuqizuar disa prej dispozitave të këtij ligji, të cilat cenonin të drejtën kushtetuese për t'u organizuar. Gjykata vendosi se detyrimi për regjistrim brenda 30 ditëve, i parashikuar nga neni 8 i ligjit, krijon një barrë joproporcionale për organizatat e reja dhe kufizon lirinë e organizimit. Gjithashtu, kompetencat e kancelarit janë në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës, pasi vetëm gjykata ka të drejtën e regjistrimit të organizatave. Për më tepër, Gjykata gjeti se dispozitatat mbi gjobat e përcaktuara në ligjin nr. 80/2021 nuk përmbushin standardet kushtetuese për qartësi dhe proporcionalitet, duke kufizuar lirinë e organizimit.²⁶

Kuadri ligjor për veprimtarinë e shoqatave përfshin edhe *ligjin për vullnetarizmin*²⁷, i cili përcakton parimet, kushtet dhe kriteret kryesore për vullnetarizmin, *ligjin për organizimin dhe*

²³ Republika e Shqipërisë. (2021). Ligj nr. 80/2021, dt. 24.6.2021: Për organizatat jofitimprurëse. <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2021/08/ligj-nr.-802021-dt.-24.6.2021.pdf>

²⁴ Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, funksionon zyra e Regjistrimit të O.J.F. në mbështetje të Ligjit Nr. 8788, dt. 07.05.2001 dhe Ligjit Nr.8789 dt. 07.05.2001 "Për Regjistrimin e O.J.F". <https://gjykatatirana.gov.al/gjykatatirana/zyrat-e-regjistrimit-te-ojf/> Deri në momentin e hartimit të këtij dokumenti, shtator 2024, regjistri elektronik nuk është bërë ende funksional.

²⁵ Kërkesa është drejtuar nga Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Civil Rights Defender Dega Tiranë, Këshillin Shqiptar të Medias, Aleancën kundër Diskriminimit LGBT dhe Rrjetin Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri – Ballkan.

²⁶ Shiko të plotë vendimin e Gjykatës Kushtetuese këtu: https://www.gjk.gov.al/web/NJOFTIM_VENDIMARRJEJE_2848_1-94.php

²⁷ Ligj Nr. 45/2016, PËR VULLNETARIZMIN, <https://qbz.gov.al/eli/fz/2016/92/2f033324-df83-4afc-88b8-f04967bf0052;q=Ligji%20Per%20Vullnetarizmin%20>

*funksonimi e Grupeve Lokale të Veprimit*²⁸, i cili përcakton mundësitë për angazhim qytetar nga komunitetet vendore, si dhe ligji për *Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë*²⁹, i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet e organizatave jofitimprurëse.

Për të nxitur dhe lehtësuar një rol aktiv të ShC në vend, janë ngritur struktura dhe janë vënë në dispozicion mjete të dedikuara. Struktura kryesore e dialogut dhe bashkëpunimit shtet-ShC, e krijuar me ligj është Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)³⁰, një organ këshillimor i Këshillit të Ministrave që mbledh së bashku përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), e cila është ngritur dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10093, dt. 09.03.2009: “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE”³¹, ofron ndihmë financiare për shoqërinë civile në përputhje me prioritetet dhe strategjitë e Programit të Qeverisë. Agjencia shërben për të lidhur shoqërinë civile dhe institucionet shtetërore. Deri tani, dokumenti kryesor strategjik për shoqërinë civile ka qenë 'Udhërrëfyese për politikën e qeverisë drejt një mundësimi mjedisi për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023'. Udhërrëfyese përcaktonte 3 orientime strategjike dhe 9 fushat prioritare të veprimit:

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunim i institucionalizuar qeveri-shoqëri civile në politikëbërje dhe në integrimin evropian

- Prioriteti 1: Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile
- Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të
- Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes
- Prioriteti 4: Sigurimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e aderimit në përputhje me praktikatat e mira të BE-së
- Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantë në nivel lokal

²⁸ Ligj Nr. 36/2022, PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE VENDORE TË VEPRIMIT, <https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/ligj-2022-04-14-36-P%C3%8BR-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-GRUPEVE-VENDORE-TE-VEPRIMIT.pdf>

²⁹ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013 https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Civill-2014_i_azhornuar-1.pdf

³⁰ Republika e Shqipërisë. (2015). Ligj nr. 119/2015: Për krijimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. https://www.connectwith.eu.al/wp-content/uploads/2019/06/Dokumenta-Kombetare_-2015_Ligj_Nr.119-2015_KKSHC-AL.pdf

³¹ Republika e Shqipërisë. (2009). Ligji nr. 10093, dt. 09.03.2009: PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE, <https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/ligj-2009-03-09-10093-1.pdf>

Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor & qeverisjes së të dhënave

- Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri më mundësues për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve
- Prioriteti 7: Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile

Drejtimi strategjik 3: Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm

- Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përputhje me praktikatat e mira të BE-së
- Prioriteti 9: Raportimi financiar/kontabilizimi dhe tatimi i OSHC-ve

Sipas raportimit të Shqipërisë në raportin e Komisionit Europian 2023³², cilësohet se Shqipëria ka zbatuar 85% të masave lidhur me orientimin strategjik 1³³ dhe rreth 2/3 e masave lidhur me orientimet strategjike 2 dhe 3.³⁴ Në këtë dokument, në konsultim me aktorët lokalë, ne shkojmë përtej këtyre numrave, për të kuptuar më shumë mbi ngërçet, sfidat, si dhe masat për të garantuar një mjedis mundësues për ShC dhe penguan avancimin e tendencave për tkurrje të hapësirës apo rolit të saj në vend.

PROBLEMATIKA TË MBARTURA TË SHC NË SHQIPËRI & RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN, 2023

Sikurse u trajtua edhe më sipër, ndonëse relativisht i ri, sektori i ShC-së në Shqipëri ka shënuar zhvillime të qenësishme në dekadat e fundit. Megjithatë, disa problematika kanë vazhduar ta shoqërojnë atë duke sfiduar qëndrueshmërinë, impaktin dhe ndonjëherë hapësirën e tij në tërësi apo aktorëve të veçantë. Nga shqyrtimi i raporteve dhe vlerësimeve të vazhdueshme mbi mjedisin dhe sfidat e ShC në Shqipëri³⁵, rezulton se pengesat kryesore lidhen me mangësi apo

³² European Commission (2023). Screening report - Albania, 20/07/2023. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

³³ Prioriteti 1: Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile

³⁴ Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OShC-të; Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efikase e OShC-ve në procesin e politikëbërjes

³⁵ Shiko p.sh. Dhëmbo, E. (2017). "Albania" in Civil Society in Central and Eastern Europe: Challenges and Opportunities Edited by Peter Vador, Nicole Traxler, Reinhard Millner, and Michael Meyer, ERSTE Stiftung Studies, Vienna, Austria. ISBN 978-3-902673-10-7, https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil_society_studie_issuu_e1-1.pdf; EU Policy Hub. (2018). Themelimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile: Sfide apo arritje? <https://eupolicyhub.eu/wp-content/uploads/2018/09/policy-brief-CSO2018-sq-3.pdf>; Dhëmbo, E. (2019). "Albania" in Civil Society in Central and Eastern Europe: Monitoring 2019 Editors: Eva More-Hollerweger, Flavia-Elvira Bogorin, Julia Litofcenko, Michael Meyer, ERSTE Foundation, Vienna, ISBN 978-3-902673-14-5 <https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil-society-in-central-and-eastern-europe-monitoring-2019-1.pdf>; Partners Albania for Change and Development. (2019). Needs assessment report 2019. <https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/12/Need-Assessment-Report-2019.pdf>; Bino, B, Qirjazi, R., & Dafa, A. (2021). CSO PARTICIPATION IN DECISION-MAKING IN ALBANIA. Institute for Democracy and Mediation, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/CSO-Participation-in-Decision->

papërshtatshmëri në kuadrin ligjor dhe rregullator, mjedisin operacional dhe atë politik, besimin dhe angazhimin qytetar, si dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit.

Kuadri Ligjor dhe Rregullator: Mjedisi ligjor për shoqërinë civile në Shqipëri ka pasur disa përmirësime, veçanërisht në drejtim të procesit të regjistrimit të OShC-ve, si dhe masave për rritjen e transparencës. Megjithatë, sfidat që mbeten janë ato që lidhen me paqëndrueshmërinë dhe mosvijueshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator, si dhe shqetësimet rreth kufizimeve të mundshme në raport me lirinë e organizmit. Sipas Matricës së Monitorimit 2022³⁶ mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e OShC-ve, ndërkohë që Shqipëria ka bërë njëfarë progresi, kuadri rregullator ende paraqet pengesa për rritjen dhe efektivitetin e sektorit.

Mjedisi Operacional: Ndërsa ekziston një kuadër ligjor bazë që mbështet funksionimin e OShC-ve, çështje të tilla si taksimi i granteve dhe donacioneve, pengesat burokratike dhe aksesimi i kufizuar në financimin publik mbeten problematike. Përveç kësaj, mungesa e një mjedisi të favorshëm për filantropinë dhe moszhvillimi i sipërmarrjes sociale e rëndojnë më tej qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve në Shqipëri.³⁷

Mjedisi politik: Mjedisi politik i Shqipërisë vazhdon të ndikojë në veprimtarinë e organizatave të shoqërisë civile. Vendi ka përjetuar një polarizim politik, të tillë që ndonjëherë ka rezultuar në presion ose ndërhyrje ndaj OJF-ve. Disa OShC kanë luftuar për të ruajtur pavarësinë dhe kredibilitetin e tyre në këtë kontekst, i cili është komplikuar edhe më tej nga mungesa e besimit midis shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare.³⁸

Imazhi i sektorit dhe angazhimi i publikut: Perceptimi publik mbetet një pengesë e rëndësishme për shoqërinë civile shqiptare. Ndërsa OShC-të kanë kontribuar në diskursin publik dhe kanë advokuar reforma të rëndësishme, ato shpesh përballen me skepticizëm nga publiku. Shumë qytetarë i shohin këto organizata si të shkëputura nga nevojat dhe shqetësimet e tyre, gjë që ka

[Making-in-Albania-1.pdf](#); Partners Albania for Change and Development. (2023). MONITORING MATRIX ON ENABLING ENVIRONMENT FOR CSOS DEVELOPMENT: COUNTRY REPORT FOR ALBANIA 2022. <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2022/>

³⁶ Partners Albania for Change and Development. (2023). Monitoring matrix on enabling environment for CSOs development: Country report for Albania 2022. <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2022/>

³⁷ Ibid.

³⁸ USAID. (2021). Indeksi i qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile 2021. <https://smartbalkansproject.org/wp-content/uploads/2023/07/Indeksi-i-Qendrueshmerise-se-Organizatave-te-Shoqerise-Civile-2021.pdf>; Bino, B, Qirjazi, R., & Dafa, A. (2021). CSO PARTICIPATION IN DECISION-MAKING IN ALBANIA. Institute for Democracy and Mediation, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania-1.pdf>; Dhëmbo, E. (2019). "Albania" in Civil Society in Central and Eastern Europe: Monitoring 2019 Editors: Eva More-Hollerweger, Flavia-Elvira Bogorin, Julia Litofcenko, Michael Meyer, ERSTE Foundation, Vienna, ISBN 978-3-902673-14-5 <https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil-society-in-central-and-eastern-europe-monitoring-2019-1.pdf>

penguar angazhimin më të gjerë qytetar dhe rrjedhimisht mbështetjen për iniciativat e ndërmarra. Imazhi publik i sektorit të OShC-ve u përkeqësua pak në vitin 2021 si rezultat i sulmeve të vazhdueshme përgjatë viteve të fundit nga qeveria dhe mediat e ndikuara prej saj.³⁹

Financimi dhe qëndrueshmëria financiare: Një sfidë kryesore për shoqërinë civile në Shqipëri është qëndrueshmëria financiare. Shumë OShC mbeten ende shumë të varura nga donatorët ndërkombëtarë, gjë që krijon dobësi në lidhje me ndryshimet dhe zhvendosjet (edhe gjeografike) në prioritetet e donatorëve dhe reduktimin e financimit të tyre për vendin tonë, apo për rajonin pjesë e të cilit jemi (p.sh. pandemia e covid-19 dhe lufta në Ukrainë bënë që të reduktohet vëmendja dhe financimi për zona apo tematika të caktuara). Mungesa e burimeve të larmishme të financimit ka çuar në paqëndrueshmëri financiare për shumë organizata, duke kufizuar aftësinë e tyre për të zbatuar projekte afatgjata ose për të mbajtur operacionet në mënyrë të vazhdueshme.⁴⁰

Edhe në 2023, Raporti Shqyrtues i Komisionit Europian, përtej konstatimeve të hapave të ndërmarra, evidenton një sërë sfidash që kërcënojnë hapësirat, impaktin dhe qëndrueshmërinë e sektorit në vend. Aty përfshihen:

1. *Çështjet e zbatimit dhe funksionalitetit të kuadrit ligjor për ShC:* Pavarësisht një kuadri ligjor gjithëpërfshirës dhe të konsultuar, shumë mekanizma nuk janë plotësisht funksionalë. Regjistri Elektronik Kombëtar i Organizatave Jofitimprurëse, thelbësor për thjeshtimin e regjistrimit të OShC-ve, nuk është krijuar ende dhe procedurat ekzistuese të regjistrimit mbeten të vështira.

2. *Efektshmëria e kufizuar e proceseve të konsultimit:* Edhe pse ekzistojnë platforma dhe procedura për angazhimin e OShC-ve në vendimmarrje, konsultimet shpesh janë formale, pa përfshirje dhe pa orientim proaktiv. Afatet ligjore nuk respektohen gjithmonë dhe procedurat e përshpejtuara kufizojnë kontributin domethënës të ShC. Kuadri ligjor parashikon një afat 20-ditor pune për publikimin e konsultimit elektronik, por kjo respektohet vetëm për rreth 60% të akteve dhe nuk është gjithmonë e përshtatshme për nisma politikash komplekse. Shpesh, procedurat e përshpejtuara nuk u japin kohë të mjaftueshme OShC-ve dhe palëve të interesuara të ofrojnë kontribute të qenësishme.⁴¹

³⁹ Albanian Helsinki Committee. (2022). Instrumentet ligjore dhe sfidat e angazhimit të qytetarëve dhe të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe legislative të Kuvendit: Raport studimor. <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Studimor-Instrumentet-ligjore-dhe-sfidat-e-angazhimit-te-qytetareve-dhe-te-shoqerise-civile-ne-proceset-vendimmarrese-dhe-legjislative-te-kuvendit.pdf> ; USAID. (2021). Indeksi i qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile 2021. <https://smartbalkansproject.org/wp-content/uploads/2023/07/Indeksi-i-Qendrueshmerise-se-Organizatave-te-Shoqerise-Civile-2021.pdf>;

⁴⁰ USAID. (2021). Indeksi i qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile 2021. <https://smartbalkansproject.org/wp-content/uploads/2023/07/Indeksi-i-Qendrueshmerise-se-Organizatave-te-Shoqerise-Civile-2021.pdf>

⁴¹ European Commission (2023). Screening report - Albania, 20/07/2023. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en, f.21.

3. *Mbështetje e dobët institucionale për shoqërinë civile:* Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), që synohej të lehtësonte dialogun, nuk po jep rezultatet e pritura dhe mezi funksionon, duke dështuar të përfaqësojë në mënyrë efektive prioritetet e OSHC-ve. Komisioni European konstaton nevojë urgjente për reformim, në mënyrë që të përmirësohet funksionimi dhe përfaqësimi i KKShC-së.

4. *Mbështetje e pamjaftueshme financiare dhe tatimore:* Financimi publik mbetet i pamjaftueshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e OSHC-ve, veçanërisht në rolet e ofruesve të shërbimeve. Regjimi tatimor është i pafavorshëm, i mungojnë stimujt për donacione dhe imponon procese komplekse të rimbursimit të TVSh-së.

5. *Çështje të transparencës dhe mangësive në aksesueshmëri:* Platformat digjitale dhe monitoruese të Kuvendit kanë përmirësime të pjesshme të aksesueshmërisë dhe transparencës, por problemet teknike, si mungesa e certifikatave të sigurisë, pengojnë përdorimin e plotë.

6. *Progresi i ngadalshëm në raport me Udhërrëfyesin e Mjedisit Mundësues për ShC:* Megjithëse është bërë progres, zbatimi i masave për të krijuar një mjedis të mundësues për shoqërinë civile kërkon përpjekje shtesë, burime dhe monitorim të përmirësuar, për të krijuar besim dhe për të siguruar politikëbërje të bazuar në evidenca.

PERCEPTIME MBI ZVOGËLIMIN E HAPËSIRËS SË SHC-SË DHE SHKAQEVE NGA AKTORËT LOKALË

1. TË PËRCAKTOSH DHE MASËSH HAPËSIRËN E SHOQËRISË CIVILE

Diskutimi mbi tkurrjen e hapësirë së ShC në vend sfidohet së pari nga nevoja për qartësi mbi vetë konceptet dhe kuptimet që ato marrin në kontekste dhe nga aktorë të ndryshëm. Një prej diskutimeve në fokusgrupet e realizuara nisi pikërisht me një kundërpyetje nga pjesëmarrësit- *Cila hapësirë dhe cila ShC? Vetë përcaktimi i çfarë nënkuptohet me hapësirë për ShC, kujt i referohemi dhe kë përfshijmë në diskursin për ShC, si dhe si matet kjo ‘hapësirë’, ka nevojë për vëmendje dhe adresim të vazhdueshëm. Përfaqësues të OShC-ve ngrenë shqetësimin se përcaktimi dhe operacionalizimi i termave është një problem në vetvete. ShC shpesh reduktohet në OShC, ose më saktë në pak OShC të caktuara, të cilat më shumë njihen me emrat e drejtuesve sesa emrin e misionin e tyre. Po kështu, edhe termi “hapësirë” nuk flet shumë (nëse nuk përcaktohet qartë) dhe nuk ka tregues që ta konkretizojnë. Hapësira mund të jetë e tkurrur ose ajo mund të jetë aty po nuk shfrytëzohet ose shfrytëzohet më pak se në të shkuarën dhe rezultati mund të jetë i ngjashëm, më pak rol dhe ndikim i ShC. Vetëm një qartësi e tillë mund të na tregojë nëse mekanizmat që po përdoren për krijimin apo shfrytëzimin e kësaj hapësire janë të duhurit apo nevojitet të ndryshojnë.*

Edhe gjatë intervistave me përfaqësues nga aktorë të tjerë që ndikojnë në mjedisin në të cilin veperon ShC u evidentua se ka paqartësi mbi përcaktimin e treguesve dhe mungesë të matjeve të vazhdueshme në këtë drejtim. Përfaqësues të institucioneve shtetërore argumentuan se për sa kohë, në përgjithësi, nuk ka tregues të matshëm apo edhe procese monitoruese e vlerësuese të realizuara në mënyrë institucionale për matjen e “hapësirës së shoqërisë civile” është e vështirë të diskutohet në mënyrë objektive për këtë.

“Ok, se me perceptim mund të themi që ka gjëra që nuk kanë ecur, por të thuash që ka një tkurrje ose jo, pak vështirë. Si e mat këtë gjë? Se ne vetë nuk kemi indikatorë dhe nuk kemi bërë matje të tilla. Edhe raportet që janë bërë, më tepër se në matje, janë bazuar në opinione.” (II me përfaqësues të institucioneve shtetërore)

Në tërësi, duket se ka një dakordësi se përpjekjet serioze dhe të qëndrueshme për përkufizimin, matjen, monitorimin dhe vlerësimin e hapësirës dhe rolit të ShC në vend kanë munguar, apo nuk kanë qenë mjaftueshëm të suksesshme/qëndrueshme.

“Nuk shikoj një përpjekje për ta përkufizuar dhe matur. Meriton të zgjerohet përkufizimi dhe matja.” (FG, përfaqësues nga OShC, think tank)

Mungesa e të dhënave relevante dhe të përditësuara për sektorin janë një pengesë e vazhdueshme për realizimin e matjeve të nevojshme. Ndonëse një nga prioritetet e Udhërrëfyesit ka qenë i fokusuar tek qeverisja e të dhënave të OShC-ve (prioriteti 7), progresi ka qenë i kufizuar dhe sfidat duket se mbeten afatgjata në këtë drejtim. Këto të fundit janë të kushtëzuara nga problematika të mungesës së burimeve dhe nga një harmonizim i dobët ndërinstytucional. Një shembull konkret në këtë drejtim, është mosfinalizimi i regjistrimit elektronik për organizatat jo-fitimprurëse në vend.

Pas miratimit të ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) miratoi Vendimin nr.35, datë 26.01.2022 “Për krijimin dhe funksionimin e Regjistrimit Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse”. Në bazë të këtij vendimi, krijohet regjistri elektronik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili parashikohej të ishte funksional që në fund të vitit 2023 (Fletorja Zyrtare 17/2022). Ndonëse jemi në gjysmën e dytë të viti 2024, ky regjistër nuk është bërë ende funksional. Edhe pse nga intervistat me informatorë kyç, kuptohet se jemi pranë finalizimit të procesit, digjitalizimi i regjistrimit të OShC-ve kërkon ndërveprim të bazave të ndryshme të të dhënave të menaxhuara nga institucione të ndryshme shtetërore, gjë që paraqet një sërë sfidash shtesë. Pavarësisht arsyeve konkrete, fakt mbetet mungesa e të dhënave të përditësuara.

Përtej problematikës së regjistrimit kombëtar, të dhënat për sektorin janë të pakta. Vetë AMShC nuk ofron shumë në këtë drejtim. Ajo ende nuk publikon informacione dhe statistika të aksesueshme për sektorin e OShC-ve, si p.sh. trendet e OShC-ve në vite, fushën e veprimtarisë, numrin e

punonjësve, numrin e vullnetarëve etj. Madje vetë mbledhja e dhënave duket se sfidohet nga një mungesë e theksuar qartësie.

“Kemi rreth 70-80 organizata që përfitojnë, nga rreth 200 që aplikojnë. Vetëm se është e vështirë për të mbledhur dhe disagreguar të dhëna për profilet e tyre. Edhe ato, ngaqë kanë nevojë të mbijetojnë, nuk janë shumë qartësisht të profilizuara. Për shembull ke që përfshijnë që nga rinia, të drejtat e njeriut, e me radhë deri tek anti-korrupsioni, ndaj edhe zyra e statistikave e ka të vështirë të raportojë për profilin e përfituesve.” (Përfaqësues/e nga institucion shtetëror)

Mungesa e të dhënave të përditësuara dhe raporteve mbi tendencat e sektorit dhe performacën e tij, jo vetëm që krijojnë hendek në monitorim dhe vlerësim, por edhe hapësirë për spekulime të cilat ndikojnë edhe në imazhin e ShC dhe OShC-ve të caktuara në vend.

2. ÇDO GJË NIS NGA IMAZHI – IMAZHI I SHC DHE ROLI I MEDIAS

Diskutimet mbi hapësirën dhe rolin e ShC në vend lidhen ngushtë me ato mbi imazhin e ShC dhe besimin e ndërsjellë mes aktorëve të ShC dhe aktorëve të tjerë. KShH në një studim mbi raportet e ShC dhe Kuvendit të RSh, evidentoi se këto elemente paraqesin një natyrë kushtëzuese për raportet që ndërtohen mes aktorëve.⁴²

Nga diskutimet e realizuara me përfaqësues të sektorit, kuptohet një shqetësim në rritje për cenimin e vazhdueshëm të imazhit të ShC (në përgjithësi dhe atij të OShC-ve në veçanti). Gjuha denigruese dhe sulmet ndaj OShC-ve specifike kanë ardhur në rritje, ashtu edhe ato ndaj gazetarëve dhe medieeve. Ky fakt është manifestuar në rritjen e shqetësimit mbi proceset gjyqësore të hapura ndaj tyre (të njohura edhe si SLAPPs - Strategic Lawsuit Against Public Participation).⁴³

“Me avancimet teknologjike, çdokush ka mundësinë të ketë një forum të tij, dhe shohim që ka shtim të narrativave ekstremiste që gjejnë hapësirë përmes atyre që ne i dokumentojmë si ‘digital right violations’⁴⁴ – janë narrativa ‘far right’⁴⁵ dhe nacionaliste dhe ndikojnë drejtpërdrejt në

⁴² Për më shumë shiko këtu: <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Studimor-Instrumentet-ligjore-dhe-sfidat-e-angazhimit-te-qytetareve-dhe-te-shoqerise-civile-ne-proceset-vendimmarrese-dhe-legjislative-te-kuvendit.pdf>

⁴³ Partners Albania for Change and Development. (2023). *From silence to strength: A regional response to SLAPPs in the Western Balkans*. <https://www.partnersalbania.org/publication/from-silence-to-strength-a-regional-response-to-slapps-in-the-western-balkans/>

⁴⁴ Shkeljet e të drejtave digjitale i referohen shkeljeve të të drejtave të individëve në sferën digjitale, duke përfshirë çështje që lidhen me privatësinë, lirinë e shprehjes, aksesin në informacion dhe mbrojtjen e të dhënave. Këto shkelje mund të ndikojnë në aftësinë e një personi për t'u shprehur lirisht dhe për të mbajtur kontrollin mbi informacionin e tyre personal në një botë gjithnjë e më të digjitalizuar.

⁴⁵ Pjesëmarrës/ja nënkupton ekstremimin e djathtë politik. Termi "e djathta ekstreme" i referohet një ideologjie dhe lëvizjeje politike të karakterizuar nga pikëpamje ekstreme nacionaliste, autoritare dhe kundër imigracionit. Grupet e

sulmet ndaj shoqërisë civile. Mund të marr dy shembuj që janë të muajve të fundit – e para, sulmet e vazhdueshme ndaj komuniteti LGBT, ndaj përfaqësuesve të këtij komuniteti dhe iniciativave që kanë ndërmarrë, e cila reflekton plotësisht narrativën “pro-familje”, të djathtë, konservatore – dhe e kemi edhe nga përfaqësues të lartë – që më pas është futur edhe në diskutimet në parlament si p.sh. në diskutimet për ndryshimet në ligjin për shëndetin riprodhues etj., etj. E dyta, kanë qenë organizatat që janë përfshirë shumë fort në kundërshtitë ndaj ndryshimeve të ligjit për zonat e mbrojtura. Ato u sulmuan si antikombëtare, si të blera nga grekët, apo si agjentë të huaj.” (FG, përfaqësues/e nga media)

Përkundrejt sulmeve dhe linçimit që i bëhet aktorëve të caktuar, hapësira për njohjen e kontributit dhe historive të suksesit të aktorëve të ShC vlerësohet si tejet e kufizuar. Për shembull, ka shumë pak mbulim të aktivitetit të OShC-ve dhe aksesit në mediat kombëtare është i kushtëzuar nga mundësitë financiare për të blerë hapësirë/minutazh.

“Mediat kombëtare kanë qasjen – çdo gjë me pagesë. Çfarëdo hapësire që do mund të kesh nevojë, duhet të paguash. Qoftë edhe për 1 minutë lajm për një ngjarje që ka ndodhur, që mund të jetë me rëndësi për komunitetin apo opinionin publik, televizionet duan pagesë...Donatorët ndonëse janë të interesuar për vizibilitet, nuk janë shumë entuziastë për pagesat për hapësira televizive.” (FG, përfaqësues/e nga OShC ndërkombëtare)

“[N]e kemi qenë pjesë e protestave lidhur me ndryshimin për ligjin mbi zonat e mbrojtura dhe nuk ka pasur shumë mbulim.” (FG, përfaqësues/e nga OShC e re)

“Në media ka shumë pak hapësirë për të rinjtë, për aktivizmin, sidomos mediat kombëtare...” (FG, aktivist/e)

Këto vlejné si për nivelin qendror, por edhe atë lokal. Për më tepër, filtrat dhe mekanizmat që do duhet të mbronin nga gjuha denigruese apo ajo e urrejtjes, më shumë janë ndier në tkurrjen dhe kufizimet e hapësirave për vetë aktorët e aktivizmin e ShC edhe përtej nivelit kombëtar, si për shembull në mediat sociale. Ilustrimin më të mirë për këtë situatë plot kufizime e ofroi një organizatë që operon në nivel vendor.

“[J]emi një organizatë lokale, një watchdog, në nivel kombëtar jo e jo, por edhe me rolin e medias lokale, e shikojmë shumë vështirë në raport me hapësirat që na krijohen. Jemi vazhdimisht të sulmuar – p.sh. për materiale që i shërbejnë transparencës si p.sh. mbledhjet e këshillit bashkiak, kur kemi dashur t’i japim edhe më shumë vizibilitet, ka qenë e pamundur. Facebook-u nuk na ka pranuar sponsorizimin e materialeve të tilla. Edhe pse janë materiale që nuk shkelin asnjë nga rregullat apo standardet e FB-së apo komunitetit. Këto materiale e kanë

ekstremit të djathtë shpesh advokojnë për ruajtjen e një identiteti të perceptuar kombëtar, homogjenitetit kulturor dhe vlerave tradicionale, dhe mund të shprehin armiqësi ndaj multikulturalizmit dhe parimeve të demokracisë liberale.

shumë të vështirë të shpërndahen në rrjete sociale sepse raportohen, rankohen keq si pasojë e tyre dhe bllokohen.” (FG, përfaqësues/e nga OShC lokale)

Për të adresuar këtë hendek, njohësit më të mirë të të dy ‘botëve’, gazetarë dhe përfaqësues të OShC-ve që punojnë me mediet, rekomandojnë afrimin e OShC-ve me mediet dhe eksplorimin e interesave të përbashkëta. Një shembull është ofrimi i ekspertizës që ShC ka për të mbështetur mediat përkundrejt pritshmërive për mbulim të aktiviteteve, të cilat në vetvete, nuk ngjallin ndonjë interes për to.

3. PËRTEJ IMAZHIT - PERCEPTIME DHE DËSHMI MBI NGUSHTIMIN E HAPËSIRAVE PËR SHC

3.1. TENDENCA TË PËRGJITHSHME

Përtej diskutimeve mbi nuancat e operacionalizimit të terminologjisë, pjesëmarrësit e konsultuar për konceptimin e këtij dokumenti ndanë perceptimet dhe dëshmitë e tyre mbi atë që mund të cilësohet si ‘ngushtim’ apo ‘tkurrje’ e hapësirës së ShC-së në Shqipëri. Tema nuk është aspak e re për forumet e aktorëve të ShC-së, madje disa ndihen edhe të bezdisur që ende mbetemi në nivel ‘konstatimi’ dhe ‘përshkrimi’ të problematikës, duke pretenduar mungesë vullneti apo agjencie për të sjellë ndryshimet e nevojshme. Për ta, ngushtimi i hapësirës së ShC-së manifestohet më dukshëm në sulmet dhe përpjekjet për ‘baltosjen’ e imazhit dhe aktorëve të veçantë. Praktikisht kjo është një çështje sistemike dhe strukturore, ku disbalancat e pushteteve dhe aktorëve krijojnë mjedis jomundësues, madje shtrëngues për ShC.

“Kemi pasur rast ta diskutojmë edhe me kolegë të tjerë. Në fakt jemi në këtë gjendje të një ngushtimi të hapësirës për shoqërinë civile – jo vetëm për organizatat jo-fitimprurëse, por edhe më gjerë, ku do përfshija akademikë të pavarur, organizata të gazetarëve, gazetarë të pavarur etj. E para, ku e ve re, është pjesëmarrja e ulët apo me impakt të ulët të OShC-ve në vendimmarrjen lokale dhe qendrore – procesi i konsultimit dhe llogaridhënies është tërësisht formal. Veçanërisht si ka funksionuar parlamenti, sidomos vitin e kaluar, ndryshimet ligjore që vijnë nga qeveria kalojnë një proces shumë formal të konsultimit, dhe jo të gjitha aktet e kalojnë këtë proces...Proceset janë tërësisht formale, jo gjithëpërfshirëse dhe jo-transparente. Elementi i dytë është narrativa anti-shoqëri civile. Kjo është theksuar shumë, portretizohemi si një ShC që thjesht bën letra, që thjesht merr fonde, që nuk bën asnjë gjë. Ne jemi të vetëdijshëm se jo të gjitha organizatat kanë kontribute të ngjashme apo bëjnë punë gjenuine, megjithatë ky lloj përgjithësimi dhe futja e të gjithave në një kallëp e dëmton imazhin e OShC-ve dhe për pasojë ullet besimi i qytetarëve në to e, rrjedhimisht, edhe i ndikimit që ato mund të kenë. Shtu pastaj edhe elementin e presioneve – presione të fshehura, që nëse kritikojnë mund të mos marrin më

(aq) financime apo të tëhuajësohen edhe më tepër. Ajo që i lidh të gjitha – që është çështje strukturore, sistemike – është çështja e përqendrimit shumë të madh të pushtetit në duar e qeverisë, të ekzekutivit dhe dobësimi i rolit të parlamenti apo institucioneve të pavarura, përfshi komisionerët, Kontrollin e Lart të Shtetit, Avokatin e Popullit, e kështu me radhë, të cilat do duhej të bënin kundërpeshën dhe të ngrinin rolin e OShC-ve.” (Përfaqësues/e nga OShC Think-tank)

Sipas pjesëmarrësve në këtë vlerësim, ka disa zhvillime që shkojnë përtej sektorit që e formësojnë këtë gjendje. Ato lidhen me shëndetin e demokracisë dhe vlerave sociale në vend. ‘Ndërhyrjet e politikës’, ‘kërcënimet dhe kapjet’, si dhe ‘centralizimi i pushtetit’ u përshkruan si problematike nga disa nga pjesëmarrësit në diskutime. Tendencat për kontroll shihen si jashtë ashtu edhe brenda sektorit të ShC-së.

“Jo vetëm për organizatat e shoqërisë civile ka ngushtim të hapësirave, por edhe më gjerë në media, akademi ka problematika të ngjashme. Mjafton të shohim zgjedhjet e fundit në universitete, pamë se edhe akademia është në trysinë e pushtetit dhe nën presionin e saj të brendshëm dhe të jashtëm. P.sh Albanologjia me një vendim të KM u mbyll dhe i kaloi Akademisë së Shkencave, 5 nga 6 universitetet në Tiranë zhvilluan zgjedhje me 1 kandidat duke vrarë garën dhe alternativën, akuzat për plagjiaturë të dy prej kandidatëve kryesorë nuk u morën në shqyrtim nga organet e universitetet përkatëse.” (Përfaqësues/e nga OShC rinore)

“Centralizimi i pushtetit që u përmend edhe më herët, është një problem kyç. Kemi edhe krijimin e strukturave të reja. Tani, edhe aq të reja jo, se ka gati 2-3 vjet që është SASPAC-u, që për mua është tregues i tendencës për kontroll të ShC. Ai ende nuk është në funksionim të plotë, pasi vënia e tij me kapacitete të plota në funksionim, do të ishte një limitim akoma më i madh për ShC. P.sh. që kur bën prokurimet e tua, ti duhet të zgjedhësh tek lista e ‘suppliers’ [ofrueve] që kanë përzgjedhur ata.” (Përfaqësues/e nga OShC ndërkombëtare)

Megjithatë, disa pjesëmarrës shprehen se këto tendenca dhe dimensionet e ngushtimit të hapësirës së ShC nuk arrijnë të jenë mjaftueshëm të dukshme, pasi situata raportohet gjithmonë më mirë nga sa ajo është në realitet dhe raportimet e qeverisë marrin përparësi kundrejt atyre të aktorëve të ShC.

“Këta [Qeveria Shqiptare] janë mjeshtra të raportimit! duhet ta pranojmë, janë ekspertë në raportimin sipas pritshmërive të BE-së. BE nga ana tjetër duke qenë me tendencën për fuqizimin e institucioneve lokale të vendeve kandidate, kur ka para dy raporte, tenton të mbështesë atë të një institucioni më tepër sesa ShC. (Përfaqësues/e nga OShC ndërkombëtare)

3.2. SFIDA TË KUADRIT LIGJOR, RREGULLATOR E OPERACIONAL

Një pjesë jo e vogël e ngushtimit të perceptuar të hapësirave për ShC i atribuohet mosavancimit të pritur të kuadrit ligjor dhe rregullator për ShC në vend, ashtu edhe sfidave për operacionalizimin dhe mirëfunksionimin e tij në praktikë. Këtu përfshihen elemente që shtrihen nga lënia në hije e

çështjes së rregullimit të vullnetarizmit në RSh e deri tek mos zbatimi dhe mungesa e raportimit të progresit për dokumentin e dedikuar për ShC – Udhërrëfyesin për ShC.

Mbështetja e vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive përbëjnë një nga prioritetet (prioriteti 5) e Udhërrëfyesit për ShC, megjithatë plotësimi/rishikimi i kuadrit ligjor në këtë drejtim nuk ka pasur zhvillimet e pritura. Mungesa e një strategjie apo programit kombëtar për vullnetarizmin ndikon në cilësinë e mjedisit për punën e OSHC-ve në vend si dhe në qëndrueshmërinë e punës së tyre. Ndonëse rishikimi i ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin” parashikohet të ndërmerret në tremujorin e tretë të vitit 2024, dialogu për të ka nisur që në vitin 2021, me angazhimin e një sërë institucioneve përgjegjëse, janë prodhuar disa opinione e studime ligjore lidhur me problemet e shumta të kuadrit ligjor për vullnetarizmin në Shqipëri dhe praktikat e vendeve të tjera të rajonit, BE dhe më gjerë, por megjithatë, deri më tani nga ministria përgjegjëse nuk janë iniciuar propozime konkrete për ndryshime ligjore.

“Ka një lloj vullneti për përmirësim të legjislacionit si p.sh. për vullnetarizmin dhe pas disa vitesh lobim, më në fund u ngrit një grup ndërministror që duket se ka vullnet të mirë për të çuar procesin përpara.” (Përfaqësues/e nga OShC kombëtare)

Një situatë e ngjashme raportohet edhe për sa i takon lehtësimit të kuadrit rregullator për regjistrimin dhe funksionimin e OShC-ve. Nën Drejtimin Strategjik 2, të Udhërrëfyesit për ShC, parashikohet prioriteti 6, për një kuadër legjislativ më mundësues për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve. Edhe pse Ligji nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë 3 vite më parë, qëllimi i tij për të thjeshtuar regjistrimin e OJF-ve nuk është arritur plotësisht. Siç u soll në vëmendje edhe më sipër, Regjistri Elektronik nuk është bërë ende funksional, duke vazhduar të mbajë ende në fuqi praktika të vjetra, të gjata dhe të kushtueshme për OShC-të. Mundësimi i regjistrimit elektronik si dhe harmonizimi i të dhënave edhe me sisteme e institucione të tjera do kontribuonte ndjeshëm në një mjedis më mundësues për ShC.

“Mungesa e një regjistri nuk mundëson as dokumentimin e kontributit që japin OShC-të në shoqëri... Ka edhe shtim të kohës për regjistrim. Sipas të dhënave nga gjykata, të raportuara në matricën për vitin 2022, është dyfishuar koha për regjistrim.” (Përfaqësues/e nga OShC kombëtare)

“Për të shtuar që ka shumë pak informacion pastaj në raport me tatimet apo edhe E-Albania për pjesën e pronarëve përfitues – janë koncepte me një outreach [shtrirje] shumë të vogël në sektor. Pra, ka nevojë për fushata informimi të vazhdueshme. Këto kanë pasur edhe kosto, p.sh. gjoba, pasi organizatat bëjnë çregjistrimin në gjykatë, por jo detyrimisht edhe pranë institucioneve të tjera, siç është p.sh. në lidhje me pronarët përfitues” (Përfaqësues/e nga OShC kombëtare)

3.3. “GJËRAT NË LETËR NUK MJAFTOJNË!” – MUNGESA E BURIMEVE DHE QARTËSIVE NË NDARJEN E ROLEVE DHE PËRGJEGJËSIVE

Përveç problematikave për mangësi në kuadrin ligjor, një pjesë e mirë e atyre që planifikohen dhe premtohen për një mjedis më mundësues për ShC mbeten vetëm në letër si pasojë e mungesës së burimeve dhe paqartësisë në role dhe përgjegjësi të aktorëve relevantë. Kjo ilustron me ecurinë e zbatueshmërisë së Udhërrëfyesit për ShC. Siç u evidentua edhe më herët, është e vështirë të raportosh mbi këtë çështje, për sa kohë nuk ka raporte monitorimi dhe vlerësimi mbi arritjet e objektivave të vendosura, edhe pse afati i përfundimit të zbatimit të udhërrëfyesit ishte Dhjetor 2023.

Aktorët e konsultuar në kuadër të hartimit të këtij dokumenti argumentojnë se zbatimi i Udhërrëfyesit ka pasur shanse minimale që në gjenezë, për dy arsye kryesore – 1. mungesa e një buxheti, dhe 2. paqartësia në përcaktimin e një roli drejtues/koordinues për zbatimin e tij.

“Udhërrëfyesi nuk kishte buxhet – që aty duket... Pastaj edhe problematika që shoqëroi koordinimin. U nis nga Kryeministria dhe pastaj kaloi tek Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por në të dy rastet nuk pati asnjë ngritje strukturash të dedikuara.” (Përfaqësues/e nga Institucion Shtetëror)

Ky ndryshim i aktorëve përgjegjës dhe paqartësia e roleve apo mospërcaktimi i qartë i tyre argumentohet se i ka lënë “gjërat pezull”. Në vitin 2023, mandati institucional për koordinimin e politikës së shoqërisë civile, u zhvendos nga Zyra e Kryeministrit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), por pa asnjë bazë ligjore apo vendim të duhur të Këshillit të Ministrave që do të tregonte qartë rolin/mandatin e Ministrisë. Situata ishte gjithashtu e paqartë lidhur me rolet e institucioneve të ndryshme publike në zbatimin e Udhërrëfyesit për shkak të ristrukturimit të brendshëm të disa prej institucioneve qeveritare.

Për më tepër, departamenti i MShMS, që është përgjegjës për/mbulimin e zbatimit të Strategjisë së Udhërrëfyesit, nuk ka burime adekuate njerëzore dhe financiare për të qenë në gjendje të operojë në mënyrë efektive. Departamenti për Politikën e Përfshirjes Sociale dhe Barazinë Gjinore është përgjegjës për zbatimin e dy strategjive të tjera (përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore). Pra, ata ndihen të mbingarkuar dhe të paaftë për të përballuar siç duhet këtë rol të ri.

Problematikës së paqartësisë së roleve dhe përgjegjësisë institucionale i shtohen edhe çështjet e mosbesimit tek to dhe vlerësimit të një performace të dobët dhe të kompromentuar nga ngjyrimet politike dhe të ndikimit të pushtetit.

“Ka 2-3 institucione përgjegjëse si AMSHC, etj. [Ajo] është përdorur politikisht nga pushtetet e ndryshëm, po jo nga sektori tonë. Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile drejtohet nga Ministri i Shëndetësisë! [Ky] është absurd më i madh se si Ministri i Shëndetësisë mund të drejtojë këtë këshill për ne. Është edhe AKR-ja që financon nismat e rinisë – ajo në fakt financon me shume bashkitë sesa organizatat rinore, nuk ka një bord të përbërë nga elementë që vijën nga jashtë, është në varësi të ministres dhe vendimmarrësit janë punonjës të kryeministrit, pra nuk është se... Roli i këtyre agjencive do duhet të ishte që ato tashmë të kishin krijuar një portofol fondesh nga donatore të huaj, por nuk kanë besueshmëri dhe konsumojnë vetëm fondet e buxhetit të shtetit – i marrin dhe i shpërndajnë vetëm në disa OJF.” (Përfaqësues/e nga Organizatë Rinore)

Edhe pjesëmarrës të tjerë ndanë shqetësimin se (mirë)funksionimi i institucioneve përgjegjëse për një mjedis mundësues për ShC në vend “i është lënë rastësisë”, duke nënkuptuar se edhe nëse ka ndodhur diçka, kjo ka qenë sporadike dhe e fragmentarizuar. Informacioni i marrë nga përfaqësues të AMSHC si sekretariat i KKShS-së, kuptohet se ka pasur diskutime të herëpashershme me OShC-të për disa prioritete të Udhërrëfyesit (p.sh. diskutimi i Ligjit 80/2021 "Për regjistrimin e OJF-ve"), por jo në mënyrë sistematike dhe konsistente. Faqja e internetit e AMSHC-së nuk ka një hapësirë të dedikuar apo një platformë komunikimi me OShC-të, për të marrë kontribute ose për të bërë të mundur përfshirjen e OShC-ve me KKShC-në, apo aktivitete të tjera lidhur me Udhërrëfyesin.

Kjo reflektohet edhe në mospërmbushjen e një tjetër prioriteti (2) që lidhet me vlerësimin e bashkëpunimit të institucioneve qeveritare me OShC-të. Sërish, në faqen e AMSHC-së, por edhe nga intervistat dhe diskutimet në FG, perceptohet një përpjekje minimale për të nxitur këtë bashkëpunim. Vetë KKShC ndër vite nuk ka mbajtur numrin minimal të mbledhjeve të përcaktuara në ligj.⁴⁶ MShMS ka vetëm një person që merret me KKShC dhe OSHC-të, si detyrë shtesë që nuk është e përfshirë në përshkrimin e punës të profilit kryesor që ky punonjës ka. AMSHC ka marrë asistencë teknike të BE-së dhe zyrtarisht ka dy persona që janë caktuar për të mbështetur KKShC-në. Megjithatë, mbështetja ende nuk është plotësisht efektive për shkak të mungesës së qartë të mandatit dhe ndarjes së detyrave.

3.4. (MOS)PËRFSHIRJA E SHC NË PROCESË POLITIKËBËRJE DHE TË INTEGRIMIT NË BE

Një tjetër prioritet i Udhërrëfyesit (prioriteti 3) fokusohet në përfshirjen e qëndrueshme dhe efektive të OSHC-ve në procesin e politikëbërjes dhe integrim në BE. Raportet vjetore për zbatimin e Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik përgatiten rregullisht, me mbështetjen e projektit të asistencës teknike të BE-së. Megjithatë, ende nuk është e mundur të monitorohet numri i OShC-ve që marrin pjesë në mënyrë aktive dhe ofrojnë të dhëna me shkrim, ose të përcaktohet

⁴⁶ Gjatë 2023, janë mbajtur 3 takime të KKShC-së, siç raportohet në raportin vjetor të AMSHC: https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Raport-Vjetor-2023-AMSHC_compressed.pdf

numri i iniciativave ligjore të ndikuar nga OShC-të. Ende nuk është e mundur të bëhet dallimi midis kategorive të ndryshme të kontribuuesve në konsultimet online dhe të paraqiten statistikat e pjesëmarrjes në konsultimet publike nga grupe të ndryshme aktorësh, duke përfshirë OShC-të.

Një arsye pse disa perceptojnë një hapësirë të tkurrur për ShC është pikërisht vijueshmëria e sfidave të identifikuar edhe më herët me konsultimin publik.⁴⁷ Raportet vjetore të KE-së për Shqipërinë ende vënë në dukje mungesën e pjesëmarrjes kuptimplotë të OShC-ve në politikëbërje. Kjo behët edhe më e vështirë kur vjen fjala për përfshirjen e organizatave dhe grupeve informale, nga zonat rurale, apo grupet vulnerabil, për shkak të mungesës së internetit dhe mungesës së aftësive për të përdorur platformat e konsultimit online, etj.⁴⁸ Raporti i IDM-së identifikon një sërë mangësish në cilësinë e angazhimit të OShC-ve në konsultimet publike dhe ofron një sërë rekomandimesh për përmirësimin e efektivitetit të zbatimit të ligjit për konsultimet publike – nga planifikimi deri te raportimi.⁴⁹

“Ashtu siç vihet re që disa nisma nuk janë kryer në konsultim të plotë me sektorin, dhe nuk rezultojnë efektive, pavarësisht dëshirës për të përmirësuar mjedisin për ShC. Në raportet tona monitoruese, konstatojmë që edhe pjesëmarrja në konsultime, proceset konsultuese, nuk duken shumë efektive – qoftë në nivel qendror, por kryesisht në atë vendor – po ashtu edhe jo gjithmonë të konsultuara. Nuk duket efektive pjesa e konsultimit sidomos nga OShC-të jashtë Tiranës.”
(Përfaqësues/e nga OShC kombëtare)

Edhe në raport me procesin e integritit përfshirja e ShC është sporadike dhe jo sistematike. Në kuadër të Prioriteti 4: Sigurimi i kontributit të OShC-ve në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE në përputhje me praktikën e mira të BE-së, dhe me synimin për të siguruar një kontribut më efektiv të OShC-ve në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, u miratua Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian, me Urdhër të Kryeministrit nr. 113, datë 30.08.2019. Megjithatë, angazhimi i qenësishëm e kuptimplotë i OShC-ve në këto procese mbetet i kufizuar, kryesisht si pasojë e një komunikimi dhe transparence shumë të pakët mbi procesin.

⁴⁷ Shiko EC Annual 2023 Report for Albania (f.12-13) https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf; IDM. (2023). Research Report: A Decade of Public Consultation Law in Albania: Call for Reform <https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-law-in-albania-call-for-reform/>; AHC report 2021 <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Studimor-Instrumentet-ligjore-dhe-sfidat-e-angazhimit-te-qytetareve-dhe-te-shoqerise-civile-ne-proceset-vendimmarrese-dhe-legjislativ-te-kuvendit.pdf>

⁴⁸ Albanian Helsinki Committee. (2022). Instrumentet ligjore dhe sfidat e angazhimit të qytetarëve dhe të shoqërisë civile në proceset vendimarrëse dhe legjislative të Kuvendit. <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Studimor-Instrumentet-ligjore-dhe-sfidat-e-angazhimit-te-qytetareve-dhe-te-shoqerise-civile-ne-proceset-vendimmarrese-dhe-legjislativ-te-kuvendit.pdf>

⁴⁹ IDM. (2023). Research Report: A Decade of Public Consultation Law in Albania: Call for Reform <https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-law-in-albania-call-for-reform/>

“Ka një mungesë të qartë të përfshirjes dhe informacionit mbi procesin dhe detyrimet që lindin për shtetin shqiptar, sepse ato nuk janë vetëm për qeverinë dhe parlamentin, por për çdo institucion, përfshi ShC. Procesi i screening që Shqipëria e kaloi për grupin e parë të kapitujve brenda një viti, ka qenë një proces që kaloi shpejt, por për të cilin ka munguar totalisht informimi. Po ashtu, edhe konsultimi publik i drejtpërdrejtë ka munguar. Konsultimi nuk është vetëm publikimi online dhe pritja 30 dite, por konsultimi nënkupton përfshirjen aktive të grupeve të interesit gjatë gjithë procesit. [J]anë ngritur shqetësime për të dy udhërrëfyesit si dhe për zyrën e kryenegociatores. Gjatë një viti, nuk ka asnjë dalje publike, asnjë interviste për media, apo takim me ShC, pra, cila është transparenca e këtij procesi?! Qeveria nuk ka qenë e hapur për çfarë detyrime kemi, ç’kemi bërë dhe ç’do duhet të bëjmë.” (Përfaqësues/e nga Media)

4. MJEDISI FINANCIAR

4.1. FINANÇIMI I SHC

Mjedisi financiar ka qenë dhe mbetet një përcaktues shumë domethënës në raport me krijimin e mundësive dhe hapësirave për ShC.⁵⁰ Për këtë ai kishte një vëmendje të dedikuar edhe në Udhërrëfyes nën Drejtimi strategjik 3: Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm, me 2 prioritet kryesore, Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OShC-ve në përputhje me praktikën e mira të BE-së; si dhe Prioriteti 9: Raportimi financiar/kontabilizimi dhe tatimi i OShC-ve. Por edhe në këtë drejtim, përpjekjet dhe rezultatet e arritura kanë qenë të pjesshme. Janë zbatuar pjesërisht disa veprime në lidhje me financimin publik dhe kuadrin tatimor, ndërkohë që ka ende pengesa për zbatimin e plotë të këtyre aktiviteteve që duhen kapërcyer në të ardhmen.

Rritjet e fondeve nga buxheti i shtetit, destinuar për mbështetjen e ShC kanë qenë të ulëta, ndërsa AMShC nuk ka arritur ende të ngrëjë fonde shtesë, më tepër sesa për kufizime në kapacitete për ta arritur një gjë të tillë, nga kufizime të kuadrin rregullator që do i mundësonin ngritjen dhe lëvrimin e këtyre fondeve shtesë. Është e vështirë të thuhet se sa janë fondet që shkojnë në mbështetje të ShC. Sekretariati duhet të kishte nisur nga raportimi për KKShC, por ende nuk është bërë një gjë e tillë – aty duhet të përfshihen edhe paratë që jepen përmes ministrive të linjës si p.sh. kultura, drejtësia, mjedisi, rinia, etj., që renditen ndër ato ministri linje që japin fonde për ShC.

⁵⁰ Shiko p.sh. Dhëmbo, E. (2019). “Albania” in Civil Society in Central and Eastern Europe: Monitoring 2019 Editors: Eva More-Hollerweger, Flavia-Elvira Bogorin, Julia Litofcenko, Michael Meyer, ERSTE Foundation, Vienna, ISBN 978-3-902673-14-5 <https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil-society-in-central-and-eastern-europe-monitoring-2019-1.pdf>; Dhëmbo, E. (2017). “Albania” in Civil Society in Central and Eastern Europe: Challenges and Opportunities Edited by Peter Vandor, Nicole Traxler, Reinhard Millner, and Michael Meyer, ERSTE Stiftung Studies, Vienna, Austria. ISBN 978-3-902673-10-7 https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil_society_studie_issuu_e1-1.pdf



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

“Rritje të financimit nga buxheti i shtetit ka pasur, po shumë pak. Ato janë mundësitë. Megjithatë, AMShC mund të ngrejë fonde shtesë, dhe nuk është se nuk ka burime njerëzore – gati gjysma e stafit i ka kapacitetet për të ngritur fonde dhe janë trajnuar vazhdimisht. Ka disa ngërçe të tjera... kufizon përvoja në menaxhimin e fondeve të mëdha si dhe burokracitë që lidhen me llogaritë bankare. Çdo gjë duhet të kalojë nga buxheti i shtetit dhe kjo shton sfidat e menaxhimit. Megjithatë, disa eksperiencë si partnerë dhe jo lead applicant [aplikanti kryesor] janë bërë dhe me pak më shumë vullnet mund të mundësohet edhe ngritja e fondeve shtesë, që besoj do jetë një prioritet edhe në udhëzuesin e ri.” (Përfaqësues/e nga Institucion Shtetëror)

“Sektori është i dobët. Duket nga sa rëndësi i jepet agjencisë përkatëse dhe paratë që alokohen. P.sh., media që është e rëndësishme dhe e fuqishme, ata harxhojnë milionat për t'i kapur. Ne, si duket, jemi të pakapshëm, ndaj nuk harxhojnë [nënqesh].” (Përfaqësues/e nga OShC Think Tank)

Një sfidë tjetër që lidhet me financimin e ShC është ajo e orientimeve dhe unifikimeve të pakta në raport me mënyrën se si jepen fondet për ShC. Nuk ka ende një kornizë rregullatore gjithëpërfshirëse dhe të unifikuar për financimin publik të OShC-ve, e cila do t'i detyronte të gjitha organet publike të respektojnë të njëjtat standarde, kritere dhe procedura për ndarjen e fondeve publike për programet dhe aktivitetet e OShC-ve. Shumica e institucioneve publike që ofrojnë mbështetje financiare kanë rregullat dhe procedurat e tyre publike të veçanta në lidhje me fushën e financimit, kriteret e aplikimit, përzgjedhjen dhe kriteret e dhënies.

Edhe transparencja mungon, dhe për këtë, më shumë se për kuadër rregullator apo infrastrukturor, duhet vullnet. Neni 22 i ligjit 10093, datë 03.09.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” detyron AMShC-në të verë në dispozicion të publikut procedurat e përzgjedhjes, kontratat e lidhura ndërmjet autoritetit kontraktor dhe përfituesit, si dhe raportet për shpenzimet e fondeve, por këto raportime mungojnë. Mungesa e informacionit të detajuar mbi grantet e dhëna për OShC-të është një pengesë e rëndësishme për një përgjegjshmëri më të fortë në procesin e përgjithshëm të financimit publik të OShC-ve.

“P.sh. kemi përvojën me AKR-në, sepse kemi në fokus të rinjtë. Kemi aplikuar disa herë, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe asnjë herë nuk jemi rankuar tek fituesit, ndërkohë që fitueset nuk kanë pasur as eksperiencën e kërkuar – në nivel lokal, ato që njoh, se të tjerat nuk i njoh aq mirë dhe nuk mund të përgjigjem. Ose, ne mund të bëjmë aktivitete edhe masive me të rinj, por nuk preferohemi as nga pushteti vendor, as nga ministra, apo përfaqësues të lartë, krahasuar me kur bën ndonjë aktivitet ndonjë organizatë “dashamirëse” me pushtetin. Dhe kjo, sigurisht, është një turrje e hapësirës së shoqërisë civile përmes mungesës së vëmendjes. Në fonde të qeverisë shqiptare, të qeverisë lokale, ne e kemi të pamundur të fitojmë. Financohemi vetëm nga donatorë të huaj. Pra, mungon hapësira që ne të përfitojmë fonde nga taksat tona, në fund fare.” (Përfaqësues/e nga OShC lokale)

4.2. TAKSIMI I SHC

Taksimi i ‘padrejtë’ apo ‘njëlloj si biznesi’ ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm për OShC-të në Shqipëri. Edhe pse ka pasur ndryshime në raport me politikat e taksimit, praktika vijon të mbetet sfiduese. Kështu me ndryshimet në Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-në), OShC-të e financuara nga donatorë të huaj, duke përfshirë fondet e IPA-s, ato të BE-së, po ashtu fondet rajonale, kanë të drejtë për përjashtim nga TVSH-ja, por ndryshimi është i vitit 2023 dhe praktikatat për kontrata e siguruara me rimbursim, duket se janë edhe në zhvillim e sipër dhe ka pak informacion/qartësi mbi to. Ajo që mbetet ende e pa adresuar është mosnjohja e donacioneve nga individë si të zbritshme nga taksat për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale. Në Shqipëri, ende, donacionet e bëra nga individët nuk njihen si të zbritshme nga taksat për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale. Kjo do të thotë se individët nuk mund të zvogëlojnë bazën e tyre tatimore përmes donacioneve që bëjnë, ndryshe nga disa vende të tjera ku donacionet mund të përdoren për të ulur detyrimet tatimore. Kjo vazhdon të pengojë veprimtaritë individuale filantropike, ndërsa për donacionet e korporatave, këto stimuj tatimorë ndonëse ekzistojnë, janë të tejet marginalë.

“Ne taksohemi si biznes i madh, taksohemi ashtu edhe nga bankat e nivelit të dytë me të cilat punojmë – nga tatimet, nga bashkia gjithashtu, si dhe çdo organ tjetër. Kjo nuk është normale pasi një organizatë nuk ka ku i merr këto para. Organizata financohen për aktivitetet e tyre në arritjen e qëllimeve që kanë, por jo për këto kosto.” (Përfaqësues/e nga OShC rinore).

Disa e lidhin këtë mjedis jo mundësues me një lloj tendence për të atakuar ShC dhe veçanërisht OShC të caktuara. Kjo më shumë se një ngushtim të hapësirës, mund të çojë në një ‘deformim’ të saj, duke nënkuptuar standarde të ndryshme në trajtim.

“OShC-të paguajnë të gjitha detyrimet si biznese, nuk i rimbursohet asnjë gjë. Ne jemi targetuar edhe nën optikën e rrezikut të pastrimit të parave. Ndërkohë, OJF është edhe p.sh. Komiteti Mysliman Shqiptar, por asnjëri nuk është në gjendje dhe nuk i kërkon pasqyrat financiare. Thonë, na ka thënë “Money laundry” [pastrimi i parave] të merremi me OJF-të, kur ne vetë jemi të financuar nga donatorë të huaj të cilët mbështesin dhe bëjnë presion për problematikën e pastrimit të parave. E gjitha kjo krijon një lloj deformimi në atë mjedisin mundësues për ShC.”
Përfaqësues/e nga OShC think tank)

Politikat e taksimit kanë nevojë jo vetëm të jenë më mundësuese, por edhe të krijojnë qëndrueshmëri dhe qartësi. Nevoja për krijimin dhe stabilizimin e praktikave të mira si dhe informimi dhe njohja lidhur me to është një domosdoshmëri për një mjedis financiar më mundësues për ShC. Kjo kërkon një qëndrim më të hapur dhe bashkëpunues ndërinstitucional dhe një qasje më proaktive nga palët.

“Lidhur me legjislacionin për rimbursimin e TVSh-së. Ka pasur tre ndryshime vetëm brenda 2023. Kjo ka krijuar një lloj konfuzioni në sektor. VKM-ja ka synuar përjashtimin që në fillim të OShC-ve nga TVSh, por duke mos vendosur në dispozicion strukturat e nevojshme, kjo ka sjellë mos-zbatueshmëri dhe konfuzion jo vetëm tek OShC-të, por edhe tek bizneset e përfshira apo edhe te donatorët lidhur me zbatimin e ligjit.” (Përfaqësues/e nga OShC kombëtare)

“Shpesh duket sikur palët e shohin njëri-tjetrin si armiq. Në një tryezë të përbashkët që patëm, përfaqësues nga zyra e tatim-taksave pyetën përfaqësuesit e OShC-se kush kishte shkuar dhe nuk kishte arritur të kryente punë. Në fakt, disa OJQ që ngritën shqetësimin, dukej që nuk ishin shumë të qarta se çfarë nuk kishte shkuar konkretisht. Mendoj se ka nevojë për informim dhe krijim të shembujve të cilët mund të replikohen më lehtësisht pastaj në praktikën e përditshme.” (Përfaqësues/e nga Institucion Shtetëror)

Një mjedis jo mundësues financiar jo vetëm që ngushton hapësirat për OShC-të, por kërcënon edhe me tkurrje të një natyre tjetër. Një pjesë e OShC-ve të vogla, të reja, apo që e kanë më të mundur mobilitetin, po shqyrtojnë dhe aplikojnë migrimin si mundësi.

“Tek ne, ke s’ke aktivitet, duhet të kesh administrator, duhet të paguash sigurime, duket lënë një vit në status pasiv... janë kosto, ndaj i drejtohen Kosovës, ku nuk i kanë këto [kosto].” (Përfaqësues/e nga Organizatë rimore)

4.3. ROLI I DONATORËVE

Në raport me mjedisin financiar dhe hapësirave që krijon apo mbyll një mjedis financiar (pa)mundësues, donatorët vlerësohen si aktorë shumë të rëndësishëm. Sipas pjesëmarrësve në konsultime, paratë e vëna në dispozicion për ShC në vend janë të papërfillshme në raport me mbështetjen që ShC merr nga donatorët.

“Sasia e parave që jepet nga institucionet shqiptare është thuajse irelevante – rreth 200,000 Euro nga AMShC, dhe ministritë kanë pak ose aspak fonde, si p.sh. Ministria e Punëve të Jashtme, etj.” (Përfaqësues/e nga OShC think-tank)

Disa standarde dhe zhvillime të përcaktuara me një qasje ‘top-down’ nga donatorët e kanë shtuar presionin dhe kufizimet në punën e OShC-ve në mënyra të ndryshme. Këtu paraqiten disa nga këto sfida, ndonëse jo në mënyrë ezauruese.

Ngurtësia e politikave dhe praktikave të donatorëve në raport me mbështetjen vetëm të organizatave formale, kombinuar me kushtet e kostove të regjistrimit dhe mbajtjes formalisht ‘hapur’ të një organizate, siç u trajtuan më sipër, minon aktivizmin e qytetarëve – individë apo grupe interesi informale. Po kështu, buxheti mbetet i ngurtë dhe reflekton pak mbi dinamikat bashkëkohore apo kontekstin.



“Donatorët duhet të jenë më të hapur dhe më fleksibël me mbështetjen e individëve dhe grupeve informale. Duhet pasur kujdes me sub-grantimet që i kanë futur organizatat e vogla në burokraci shumë të mëdha. Sub-granting në vetvete është mirë, por kur shoqërohet me shumë burokraci edhe për tenderime më pak se 1,000Eur, kthehet nga mundësues në pengues.” (Përfaqësues/e nga OShC think-tank)



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

“Ndaj na lindi edhe nevoja për një media lokale, pasi e kishim të pamundur të gjenim hapësira. Ti mund të buxhetosh realizimin e nj video senibilizuese, por e pamundur të buxhetosh minutazh transmetimi.” (Përfaqësues/e nga OShC lokale)

Skemat e nën-grantimit, ndryshe nga pritshmëria për një mbështetje më të gjerë të ShC, vlerësohen se kanë dhënë efekt të kundërt, duke krijuar ngarkesë pune artificiale për projekte shumë të vogla, aktiviteti dhe efienca e të cilave mbytet nga mbingarkesa e burokracisë së raportimeve të detajuara dhe voluminoze. Kjo ndihet veçanërisht nga organizatat që operojnë në nivel lokal dhe skemat e nën-grantimit mund të jenë nga të vetmet që arrijnë të aksesojnë.

“Fonde jashtëzakonisht të vogla, por që na duhet të bëjmë raportime si ato të Bashkimit European. Ndërkohë, ideja ka qenë për lehtësim, por... – tani, ose do duhet të bëjmë punë që kemi thënë që do bëjmë, ose do shpenzojmë kohën me raportime. Me kapacitete që kemi, të dyja bashkë, është e pamundur.” (Përfaqësues/e nga OShC lokale)

Së fundmi, kushtëzimet mbështetjes financiare me bashkëpunime me institucione qeveritare e vështirësojnë punën e OShC-ve në përgjithësi dhe veçanërisht të atyre që perceptohen si ‘opozitare’ apo ‘pa peshë’ duke cenuar më tej hapësirën potenciale për aktivizëm dhe ShC të angazhuar.

“Qasja që kanë shumë donatorë, që lidhet me fuqizimin e institucioneve në vend, për zbatimin e projekteve apo kur dëshiron të aplikosh për një projekt, ti si organizatë duhet të kesh partneritet me institucionet shtetërore, qoftë në nivel lokal, qoftë në nivel qendror. Kjo bën shpesh që të shkohet drejt një kompromisi. Institucionet luajnë me këtë pjesë, është një mënyrë për të thënë që gjërat bëhen sipas rregullave të tyre.” (Përfaqësues/e nga OShC ndërkombëtare)

5. PROBLEMATIKA DHE SFIDA TË TJERA

5.1. KONKURRENCA E PADREJTË DHE KORRUPSIONI I VETË SEKTORIT

Ngushtimi i hapësirave dhe mjedisi jo mundësues nuk lidhen vetëm me faktorë jashtë sektorit. Veçanërisht organizatat e vogla, ato lokale, apo organizatat e reja ndjejnë se këto hapësira në radhë të parë ngushtohen apo ‘zaptohen’ nga aktorë të tjerë të ShC si pasojë e dy faktorëve kryesorë –

konkurrencës së padrejtë dhe korrupsionit që ka brenda vetë sektorit. Sipas pjesëmarrësve në diskutimet ne FG, këto problematika sa kanë ardhur dhe janë thelluar.

“Sidomos që nga viti 2019 ka një lloj monopolizimi – ka vetëm rrjetëzime dhe shumë miq! Shto faktin që është shumë vështirë të krijosh një organizatë të re. Kërkon rreth një vit procedura – e thashë edhe më parë, shumë po i drejtohen Kosovës, sepse mjedisi këtu është shumë dekurajues, sidomos për të rinjtë.” (Përfaqësues/e nga OShC rinore)

Nën ombrellën e konkurrencës së padrejtë, përfaqësues të ShC kategorizojnë edhe ‘dominimin e tregut vendas nga organizatat e huaja, ndërkombëtare’. Ata perceptojnë një konkurrencë të pandershme bazuar në hendeqet e mëdha që ekzistojnë në burime dhe kapacitete mes tyre dhe organizatave ndërkombëtare. Kjo i bën të ndihen të pafuqishëm si për të konkurruar, ashtu edhe për ta adresuar këtë shqetësim.

“Një gjë që, me sa e njoh rajonin, është problematike vetëm në Shqipëri, lidhur me një mjedis më mundësues, është përfshirja e vetë këtyre organizatave të mëdhaja, siç janë OSBE, Këshilli i Europës, UNDP-ja, GiZ-i, e kështu me radhë, që – nuk e di, se nuk kam bërë ndonjë përlogaritje sa për qind marrin, nuk di nëse ka ndonjë studim të tillë, por di që p.sh. në Maqedoni e Mal të Zi nuk ekzistojnë këta operatorë kaq të mëdhenj dhe ka më shumë hapësirë për organizatat vendore, që ato të përfshihen, rriten, e profilizohen. Aktualisht, OShC-të janë “kçk” [kap çfarë të kapësh], sepse ndryshe nga rajoni, p.sh. edhe në Serbi, organizatat kontaktohen vazhdimisht dhe kanë mundësi edhe të profilizohen. Tek ne nuk ka një profilizim, kush merret me aktivizëm, kush me think-tank-izëm, e kështu me radhë, por të gjitha bëjnë gjithçka. Kjo e ngushton hapësirën. Kjo ndikon edhe tek burimet njerëzore se nuk i ndërton dhe profilizon dot. P.sh. nuk fokusohesh dot që të ndërtohet një profil think-tank dhe të merresh me studime. Jo, thonë donatorët, i dimë gjërat ne, tani dilni në terren dhe bëni veprim. Pra mjedisi mundësues, nuk është vetëm qeveria. Meqë në rajonin tonë janë edhe pak si autoritariste, janë më lehtë për t’u targetuar, por nuk janë vetëm ato.” (Përfaqësues/e nga OShC Think-tank)

Vetë skemat e nën-grantimit janë përkthyer në praktikë në një lloj ‘nën-kontaktimi’ që ndodh në sektorin e ShC. Kjo, në më të paktën, duket e padrejtë dhe jo e moralshme në këndvështrimin e OShC-vë vendase. Vetë përqendrimi i fondeve në pak aktorë ngre dyshime mbi praktika të korruptuara të raporteve OShC – donatorë.

“Ne kemi rivalitet me ndërkombëtarët. Ne garojmë me organizata ndërkombëtare, ne garojmë me NDI, me OSBE, me IDEA, me organizata që kanë buxhete 100-fish më të mëdha se ne, dhe sigurisht që e kemi të vështirë të jemi konkurrues në këtë treg. Ne, më pas, kthehemi në nën-grantuesit e tyre, pasi nuk fitojmë si rivalë. Ne bëjmë punën e tyre, ata menaxhojnë fonde të mëdha, projekte të mëdha.” (Përfaqësues/e nga OShC rinore)

5.2. KRIZAT DHE ZVOGËLIMI I MBËSHTETJES

Në vitet e fundit, janë shtuar edhe disa kërcënues të tjerë të hapësirës së ShC në Shqipëri. Krizat globale (si pandemia covid-19), apo luftërat (si p.sh. ajo në Ukrainë), kanë bërë që vëmendja dhe mbështetja për rajonin në tërësi dhe ShC në veçanti të pësoj rënie të ndjeshme. Kufizimet dhe vështirësitë financiare dhe operationale kanë qenë të parat që janë ndierë. Organizatat e vogla dhe më pak të fuqizuara janë goditur në mënyrë disproporcionale.

“Gjatë pandemisë p.sh., e patëm shumë të vështirë. U detyruam dolëm në statusin pasiv dhe nuk pati asnjë ndihmë, asnjë mbështetje. Askush nuk u kujtua e ekziston edhe ShC. Jemi organizata lokale, nuk jemi të fuqishme, me fonde të mëdha që të kemi mundësi të mbulojmë periudha të tilla dhe mbijetesa bëhet tejet e vështirë.” (Përfaqësues/e nga Organizatë lokale)

“Si pasojë e pandemisë dhe luftës në Ukrainë ndryshoi prioritetet dhe kjo ndikoi edhe në uljen e fondeve tek ne. Ka ndryshim mes garantuesve dhe OShC-ve edhe kjo na ndikon në atë çfarë OShC dëshiron të japë.” (Përfaqësues/e nga Organizatë Think-tank)

Kriza si ajo e pandemisë, kanë efekte që shkojnë përtej kufizimeve dhe vështirësive të burimeve. Vetë kufizimi i të drejtave dhe lirive, ndonëse i përkohshëm, ka ndikuar në hapa pas në disa kontekste që janë thelbësore për punën e OShC-ve.

“Që mbas kovidit, jo vetëm në Shqipëri, po kudo në botë kemi kufizime të të drejtave të njeriut, për pasojë edhe të punë së ShC. Për hir të një kauze madhore siç ishte mbrojtja e shëndetit, ne i pranuan këto kufizime të të drejtave, dhe kjo u ka shkuar shumë për shtat qeverive, si qeverisë shqiptare edhe qeverive të tjera, të cilat e vazhdojnë këtë qasje.” (Përfaqësues/e nga OShC ndërkombëtare)

6. E ARDHMJA E AFËRT – MUNDËSI DHE RREZIQE

Përveç problematikave të diskutuara, pjesëmarrësit në FG shikonin hapësira për ndryshime të menjëhershme që do krijonin më shumë mundësi dhe hapësira për ShC, ashtu siç edhe donin të ngrinin vigjilencën për disa zhvillime që mund të ktheheshin në rreziqe potenciale për përkeqësimin e mjedisit për ShC në vend.

Efekt të menjëhershëm mund të sillnin masa të cilat mbështesin aktivitetin e OShC-ve të sapokrijuara apo të atyre që operojnë në zona të vështira dhe/ose me përqendrim të ulët të OShC-ve. Format e mbështetjes mund të shtihen që nga ato për përjashtim nga taksat në vitin e parë të aktivitetit tek mbështetja infrastrukturore (si p.sh. me mjedise për zyra apo zhvillim aktiviteti).



C1-EU-NPA
CLUSTER ONE OF THE ASSOCIATION PLATFORM - ALBANIA



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

“Ashtu si çdo partie politike i ofrohet një mjedis sapo është regjistruar, diçka e ngjashme mund të ishte menduar edhe për organizatat, një mjedis do ishte një ndihmesë e madhe. Sigurisht që edhe kjo pastaj duhet parë, se sipas një reportazhi të fundit, me të dhëna nga gjykata, në Shqipëri rezultonin të regjistruara rreth 13,000 OShC. Godina ishte thjesht si shembull, por pastaj mund të mendohen lehtësira të tjera sipas tipologjive dhe kritereve.” (Përfaqësues/e nga OShC ndërkombëtare)

Në mënyrë të ngjashme, mund të mendohen forma për mbështetjen e aktivitetit të grupeve joformale dhe veçanërisht të rinjve me interes për angazhim qytetar. Për këtë donatorët mund të japin shembullin e tyre duke rivizituar politikën për më shumë gjithëpërfshirje dhe mbështetje për të rinjtë dhe grupet më pak të fuqizuara në shoqëri.

“Shikoj shumë kufizime për të rinjtë. Fatmirësisht, tani bëhen projekte thuajse në çdo lëndë, dhe shikojmë ide dhe projekte brilante me natyrë sociale, por që nuk arrijnë të kanalizohen duke qenë thjesht grup të rinjsh aktivë. Pa qenë nevoja të jesh pjesë e ndonjë organizate, të mund të ndërmerresh nisma. Pse duhet gjithmonë përmes një OShC-je? Kjo duket edhe në numrin shumë të paktë të thirrjeve për individë, grupe aktivistësh...” (Mësuese, aktiviste)

Vetë OShC-të mund të bëjnë hapa konkrete dhe të menjëhershme për të fuqizuar sektorin dhe për të rimarrë hapësira apo për të krijuar hapësira të reja. Strategjitë me efektive duket se lidhen me një mirë-koordinimin, sinergji, dhe solidaritet më të madh brenda sektorit si dhe një sens më të lartë përgjegjshmërie.

“Duhet një solidaritet më i madh mes OShC-ve; vetëm duke u rrjetëzuar dhe duke u solidarizuar mes nesh mund të sigurojmë një pjesëmarrje më të madhe dhe më të gjerë. Nëse nuk e kemi këtë, sigurisht do jetë më e lehtë për qeveritë, si në proces screening apo edhe kur të jemi anëtarë. Si në Shqipëri e kudo, qeveritë nuk e kanë me qejf të kundërshtohen qoftë nga ShC apo media. Ato bëjnë çmos që puna e tyre të shfaqet si maksimale, dhe nëse gjejnë edhe aleatë në krahun tjetër, d.m.th. në krahun tonë, sigurisht që do e shfrytëzojnë.” (Përfaqësues/e nga OShC kombëtare)

“Duhet parë se sa efektivë jemi – check and balance [kontroll dhe balancim] aty ku marrim pjesë. P.sh. sa arrijmë që të mbajmë përgjegjës institucionet ku jemi pjesë, AMShC, KKShC, parlamentin, komisionin e integritetit, etj., - këtu çalojmë.” (Përfaqësues/e nga OShC kombëtare)

Në horizont ka edhe zhvillime të cilat shihen si potencial për përkeqësim të klimës për ShC në Shqipëri. Një prej tyre lidhet me hapat që po ndërmerren dhe planifikohen të hidhen përkundrejt problematikës së dizinformimit. Rregullime të cilat do duhet të mbronin nga dizinformimi mund të kthehen në më shumë kufizime të hapësirës për ShC.

“Krijimi i komisionit parlamentar anti-disinformin ka ngritur shqetësime. Ka qenë i paqartë dhe me procedura të përshpejtuara. Nuk dha mundësi të përfshihemi ne, si aktorëve të ShC, për të



përcaktuar funksionimin dhe proceset... Tematikisht është pozitive, por si do përdoret, mbetet për t'u parë – p.sh. ka shqetësim në rritje në gjithë Europën Lindor, që vende autokratike apo kuazi-autokratike po përpiqen për të iniciuar nisma të formave “anti-foreign agents” [kundër agjentëve të huaj] – në Hungari dështoi, po në Gjeorgji kemi parë një kufizim të jashtëzakonshëm të funksionimit të organizatave, mediave, aktivistëve... Është çështje delikate dhe mbetet për t'u parë si do të funksionojë, por mungesa e informimit dhe e konsultimit janë shumë shqetësuese, për një çështje ku ShC, media do duhet të kishin rol kryesor.” (Përfaqësues/e nga media)



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Së fundi, ka konstatime se procesi i integritimit në BE nuk po shfrytëzohet siç duhet dhe se më shumë duhet bërë për të maksimizuar hapësirën e ShC në këtë proces. Përveç shqetësimit të reduktimit të ardhshëm të fondeve, pasi “Kur vendi përparon drejt anëtarësimit, bëhet “ineligible” [i papërshtatshëm] për shumë fonde dhe AMShC do duhej vetë të ngrinte fonde të tjera, por në këtë ata janë totalisht mbrapa.” (Përfaqësues/e nga OShC think-tank), ka një optimizëm të ulët se procesi do të jetë mjaftueshëm i hapur, me pjesëmarrje dhe i konsultuar me ShC.

“Be dhe screening do krijojë mundësi – nuk kam dyshim që ligjet do të rishikohen dhe përmbushin standardet e kërkuara, problemi është ç’vjen më pas, dhe e dimë që problemi kryesor është implementimi. Ndërkohë, vetë BE nuk është në një moment të mirë. E pamë edhe me zgjedhjet për parlamentin europian. Problematikat e BE do të reflektohen edhe të mundësitë që do krijohen për ne si vend që aspiron anëtarësimin.” (Përfaqësues/e nga OShC ndërkombëtare)

“Konsultimet të bëhen në mënyrë të qenësishme. P.sh. si sigurohet që ato 2-3 organizata që marrin pjesë janë konsultuar gjerësisht? Sigurisht që jo të gjitha organizatat duhet të bien dakord dhe të jenë në një mendje – sepse vijnë edhe kritika nga ndërkombëtarët që ju keni mendime të ndryshme dhe nuk bini dakord – është shumë normale se kemi pozicione dhe përfaqësojnë grupe interesi të ndryshme. Kjo nuk duhet përdorur për të delegitimuar sektorin, por përkundrazi, kjo është një demokraci zërash brenda sektorit që duhet dëgjuar e plotë.” (Përfaqësues/e nga media)

Qeveria e Shqipërisë ka hedhur së fundmi për konsultim një dokument të ri për politikën që do të hartohen në 2-3 vitet e ardhshme. Ai do udhëzojë të gjithë fondet që do përfitohen nga BE lidhur me procesin e anëtarësimit, për vitet që do të vijnë. Kjo do na ndikojë në mënyrën se si do shpërndahen dhe aksesohen këto fonde. Sipas pjesëmarrësve në FG, konsultimi nuk ka arritur tek grupet e interesit dhe grupet vulnerabil. Për këtë lloj konsultimi, vetëm platforma nuk mjafton.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit për hartimin e këtij dokumenti, rikonfirmohen dhe ridimensionohen disa shqetësime të cilat krijojnë perceptimin e një ngushtimi të hapësirës apo të një mjedisi jo mjaftueshëm mundësues për shoqërinë civile në vend. Edhe pse ende nuk ka një raport vlerësimi mbi arritjet në hapësirën e veprimit të Udhërrëfyesit për ShC, zbatimi i masave të parashikuara për të krijuar një mjedis të mundësues për shoqërinë civile kërkon përpjekje shtesë, burime dhe monitorim të përmirësuar për të krijuar besim dhe për të siguruar politikëbërje të bazuar në evidenca.

Ndërkohë, një sërë problematikash kanë vijuar të mbarten në kohë, pa marrë vëmendjen e domosdoshme për adresim ose pa arritur rezultate të qëndrueshme. Çështjet e zbatimit dhe funksionalitetit të kuadrit ligjor për ShC mbeten ende problematike dhe efektshmëria e proceseve të konsultimit e kufizuar, ndër të tjera si pasoj e aksesit të dobët dhe transparencës së ulët. Mbështetje institucionale për ShC mbetet e dobët dhe roli i Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) ende marginal. Mjedisi financiar ka parë vetëm përmirësim të vogël në termat e parave publike të shtuara në mbështetje të ShC, por financimi publik mbetet i pamjaftueshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e OSHC-ve, veçanërisht në rolet e ofruesve të shërbimeve. Regjimi tatimor është i pafavorshëm, i mungojnë stimujt për donacione dhe imponon procese komplekse të rimbursimit të TVSH-së.

Një përkeqim i diskutit të përdorur në raport me ShC, atakimit të vazhdueshëm të saj apo aktorëve të veçantë, si dhe problematika të imazhit, konkurrencës dhe korrupsionit brenda sektorit shtojnë sfidat për ShC dhe adresimin e problematikave të identifikuar dhe të nënvizuara edhe nga Raporti i Këshillit të Europës për 2023.

Në kuadër të këtyre përfundimeve, të gjetjeve të elaboruara në këtë dokument, si dhe ideve dhe sugjerimeve të ndara nga pjesëmarrësit në intervista dhe fokusgrupe, konkludojmë se rekomandimet e mëposhtme, për aktorë të ndryshëm, mund të ndihmojnë për një mjedis më mundësues dhe për një hapësirë më të madhe dhe të qëndrueshme për ShC në Shqipëri.

REKOMANDIME PËR LIGJBËRËSIT DHE POLITIKËBËRËSIT

1. Plotësimi i kuadrit ligjor, politik dhe institucional

Për një kuadër ligjor më mundësues dhe operacional, mund të ndërmerren nismat e mëposhtme:

- Kryerja e një analize ex-post të zbatimit të ligjit nr. 80/2021 për të identifikuar fushat për përmirësim, plotësimi i vakumit ligjor, si dhe reflektimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese

- Rishikimi i Ligji për KKShC-në për të qartësuar rolin, mandatin dhe përbërjen e tij, duke siguruar që ai të funksionojë në mënyrë efektive përmes konsultimeve të gjera me OShC-të, ministrinë, donatorët dhe palët e tjera të interesuara.
- Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor për vullnetarizmin, duke siguruar një proces konsultativ me OShC-të.
- Mundësimi i regjistrimit elektronik, funksional dhe të aksesueshëm, me të dhëna të harmonizuara edhe me sisteme të tjera në vend (si p.sh. taksat dhe tatimet etj.)
- Lehtësimi i politikave dhe procedurave të taksimit për OShC-të (duke konsideruar edhe qasje të diferencuara për organizatat e reja, të vogla, periferike etj.), në nivel qendror dhe vendor, si përfshirja e stimujve për donacionet/bamirësinë. Minimizimi i ndryshimeve të shpeshta dhe informimi i gjerë për ndryshimet duke lehtësuar procedurat për zbatim.
- Rritja e financimit të ShC nga fondet publike si dhe ngritja e fondeve shtesë (p.sh. nga AMSHC), për një mjedis financiar më mundësues dhe për zbutje të varësisë nga donatorët dhe prioritet e tyre. Alokimi me transparencë i fondeve dhe monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i efikasitetit të përdorimit të tyre. Shqyrtimi i formave të tjera të mbështetjes (p.sh. mbështetje infrastrukturore, zyra etj.)

2. Analiza e situatës dhe vijueshmëria e Udhërrëfyesit

Në vijim të Udhërrëfyesit të parë, rekomandohet përgatitja e një analize të plotë të situatës për fushat kryesore të trajtuara në të, në mënyrë që Udhërrëfyesi i ardhshëm të jetë i informuar plotësisht nga evidencat dhe të ketë objektiva dhe tregues të realizueshëm dhe të matshëm.

3. Përgjegjësia dhe Koordinimi Institucional

Rekomandohet përcaktimi i qartë i përgjegjësisë institucionale brenda qeverisë për koordinimin e politikave të shoqërisë civile, duke përfshirë hartimin, monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike. Sigurimi i mbështetjes administrative për realizimin e përgjegjësie.

4. Konsultimi i gjerë dhe domethënës i ligjeve dhe politikave

Mekanizmat në dispozicion për konsultimin e ligjeve dhe politikave për ShC në veçanti, si dhe ato në përgjithësi, kanë ardhur duke u përmirësuar. Megjithatë, është inkurajohet kombinimi i mekanizmave dhe qasjeve të ndryshme për realizimin e konsultimeve me bazë të gjerë, që janë domethënëse, efektive dhe jo formale, dhe që arrijnë tek të gjitha grupet e interesit.

REKOMANDIME PËR DONATORËT DHE KOMUNITETIN NDËRKOMBËTAR:

1. Rritja, diversifikimi, dhe përmirësimi i mbështetjes

Rekomandohet rishikimi i politikave të grant-dhënien duke adresuar nevojat e sektorit për mbështetje të grupeve informale dhe iniciativave më ‘grass-root’ dhe me qasje nga ‘poshtë-lart’, duke mundësuar mbështetjen e kostove që nuk lidhen drejtpërdrejt me aktivitet dhe rezultatet, por edhe me operacinalizimin e OShC-ve, PR-in e tyre etj., si dhe duke ulur burokracinë artificiale dhe/ose disproporcionale si në rastin e skema të sub-grantimit.

Dekurajimi i praktikave të ngjashme me ‘nën-kontraktimin’, ku janë organizata ndërkombëtare që financohen për të realizuar më pas aktivitetet përmes organizatave më të vogla, lokale. Kjo do ndihmonte në adresimin e asaj që OShC-të vendase e shohin si ‘konkurrencë të padrejtë’. Një mënyrë për ta shmangur këtë, është dedikimi i thirrjeve dhe buxheteve për tipologji të ndryshme të OShC-ve dhe raportimi dhe transparencja financiare përkatëse. Kjo nga ana tjetër do qartësonte dhe adresonte dyshimet për korrupsion në sektor lidhur me ‘pse përfitojnë gjithmonë të njëjtat organizata apo të njëjtët njerëz?’.

2. Respektimi i diversitetit të ShC

Komuniteti i donatorëve dhe aktorëve ndërkombëtarë duhet të krijojë politikat dhe mekanizmat për gjithëpërfshirje dhe dëgjimin e të gjitha zërave të ShC, duke respektuar diversitetin brenda saj dhe duke mos shtrënguar apo intimiduar me cilësimet si dobësi kur ShC nuk ka qëndrime të harmonizuara.

3. Mbështetje për anëtarësim në BE dhe një rol më të qenësishëm të ShC

Rekomandohet zhvillimi i skemave për të financuar kontributet e OShC-ve në procesin e anëtarësimit në BE, duke siguruar që vetë OShC-të janë pjesë efektive e programimit të fondeve të BE-së.

REKOMANDIME PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC)

1. Mirëkoordinimin për monitorimi dhe pjesëmarrja

Ka hapësirë për përmirësim të koordinimit të aktorëve të ShC për të siguruar një angazhim më të madh dhe në mënyrë aktive për monitorimin e zbatimit të politikave dhe ligjeve për ShC si dhe për të qenë më pjesëmarrës dhe aktivë në aktivitetin e KKShC dhe institucioneve dhe agjencive të tjera relevante.

2. Përfshirja në konsultimeve publike në mënyrë të përgjegjshme dhe të përgjigjshme

Inkurajohet një mirë-planifikim për të siguruar pjesëmarrje domethënëse në proceset konsultive. Kjo jo vetëm për të qenë pjesë, por për ta bërë këtë me përgjegjësi dhe përgjigjshmëri ndaj grupeve të interesit apo aktorëve të tjerë të ShC që mund të mos kenë mundësi/kapacitete për të qenë pjesë.

3. Transparenca dhe llogaridhënia

Filloni nga vetja duke siguruar një shkallë më të lartë të transparencës dhe llogaridhënies. Kjo do të kontribuonte në një njohje më të mirë të sektorit dhe aktorëve të veçantë si dhe ndikonte drejtpërdrejt në imazhin për ta.

4. Shfrytëzim më i mirë i kapaciteteve dhe punës vullnetare



Krijoni rrjetëzime për të mundësuar një njohje dhe shfrytëzim më të mirë të burime dhe kapaciteteve. Krijoni një databazë për njohjen dhe menaxhimin e punës vullnetare që bëhet dhe ofrohet nga OShC-të.



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

REKOMANDIME PËR MEDIAT:

1. Transparenca dhe Përgjegjshmëria Publike

Promovoni transparencën dhe përgjegjshmërinë publike duke bashkëpunuar me ShC në përgjithësi, veçanërisht me KKShC-në dhe institucionet e tjera relevante, duke bërë transparencë për aktivitetin e tyre, vendimmarrjet e tyre etj.

Inkurajoni raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike, duke siguruar që të dhënat e kontribuuesve sipas kategorive, duke përfshirë OShC-të, të komunikohen qartë dhe të ndiqet se ç'ndodh më pas me to.

2. Mbuloni ShC, “në të mirë, e në të keq”

Krijoni hapësirë në media dhe mbuloni çështjet që i takojnë ShC dhe qytetarisë aktive, jo vetëm për problematika dhe dështime të ShC dhe aktorëve të veçantë, por edhe për shqetësimet dhe arritjet e tyre.

Gjeni pika të përbashkëta takimi dhe interesi për të shfrytëzuar atë ç'ka palët mund t'i ofrojnë njëri-tjetrit.

REFERENCA

- Albanian Helsinki Committee. (2022). *Instrumentet ligjore dhe sfidat e angazhimit të qytetarëve dhe të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe legislative të Kuvendit: Raport studimor*. <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Studimor-Instrumentet-ligjore-dhe-sfidat-e-angazhimit-te-qytetareve-dhe-te-shoqerise-civile-ne-proceset-vendimmarrrese-dhe-legjislative-te-kuvendit.pdf>
- Arnstein, S. R. (1969). A ladder of citizen participation. *Journal of the American Planners*, 35(4), 216–224.; Pateman, C. (1970). *Participation and democratic theory*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Baba, C., Cherecheș, R., Mora, C., & Țiclău, T. (2009). Public participation in public policy process – Case study in seven counties from North-Western region of Romania. *Transylvanian Review of Administrative Sciences*, 26E, 5–13. f. 5-13
- Bino, B, Qirjazi, R., & Dafa, A. (2021). *CSO PARTICIPATION IN DECISION-MAKING IN ALBANIA*. Institute for Democracy and Mediation, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/CSO-Participation-in-Decision-Making-in-Albania-1.pdf>
- Council of Europe (2020) *GEORGIA Handbook on Transparency and Citizen Participation*
- Dhëmbo, E. (2017). “Albania” in *Civil Society in Central and Eastern Europe: Challenges and Opportunities Edited*, by Peter Vandor, Nicole Traxler, Reinhard Millner, and Michael Meyer, ERSTE Stiftung Studies, Vienna, Austria. ISBN 978-3-902673-10-7, https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil_society_studie_issuu_e1-1.pdf
- Dhëmbo, E. (2019). “Albania” in *Civil Society in Central and Eastern Europe: Monitoring 2019*, Editors: Eva More-Hollerweger, Flavia-Elvira Bogorin, Julia Litofcenko, Michael Meyer, ERSTE Foundation, Vienna, ISBN 978-3-902673-14-5 <https://www.erstestiftung.org/wp-content/uploads/2020/02/civil-society-in-central-and-eastern-europe-monitoring-2019-1.pdf>
- European Commission (2023). *Screening report - Albania*, 20/07/2023. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en
- European Commission. (2021). *DG NEAR guidelines for EU support to civil society in the enlargement region, 2021–2027*. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/dg-near-guidelines-eu-support-civil-society-enlargement-region-2021-2027_en
- EU Policy Hub. (2018). *Themelimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile: Sfide apo arritje?* <https://eupolicyhub.eu/wp-content/uploads/2018/09/policy-brief-CSO2018-sq-3.pdf>;
- Freedom House (2024), *NATIONS IN TRANSIT 2024*, https://freedomhouse.org/sites/default/files/2024-04/NIT_2024_Digital_Booklet.pdf.
- Geurtz, C., & Van de Wijdeven, T. (2010). Making citizen participation work: The challenging search for new forms of local democracy in the Netherlands. *Local Government Studies*, 36(4), 531–549.

- IDM. (2023). *Research Report: A Decade of Public Consultation Law in Albania: Call for Reform* <https://idmalbania.org/research-report-a-decade-of-public-consultation-law-in-albania-call-for-reform/>;
- Ministria e Mbrojtjes e RSH (2015), *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015–2020*, https://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf
- Ministria e Drejtësisë e RSH (2022), (2023). *Plani kombëtar për integrimin evropian 2023–2025*. <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN-2023-2025.pdf>
- Partners Albania for Change and Development. (2023). *From silence to strength: A regional response to SLAPPs in the Western Balkans*. <https://www.partnersalbania.org/publication/from-silence-to-strength-a-regional-response-to-slapps-in-the-western-balkans/>
- Partners Albania for Change and Development. (2023). *Monitoring matrix on enabling environment for CSOs development: Country report for Albania 2022*. <https://www.partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2022/>
- Partners Albania for Change and Development. (2019). *Needs assessment report 2019*. <https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/12/Need-Assessment-Report-2019.pdf>
- Pitkin, H. F. (2004). Representation and democracy: Uneasy alliance. *Scandinavian Political Studies*, 27(3), 335–342.
- Quick, K. S., & Bryson, J. M. (2016). Public participation. In C. Ansell & J. Torfing (Eds.), *Handbook on theories of governance* (pp. 158–169). London: Edward Elgar.
- Radzik-Maruszak, K., Haveri, A., & Pawłowska, A. (2020). Pro-civic representation? Citizens' participation in the opinion of Finnish and Polish local councilors. **Transylvanian Review of Administrative Sciences**, (60E), 85–103. <https://doi.org/10.24193/tras.60E.6>.
- Republika e Shqipërisë. (2022) Ligj Nr. 36/2022, PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPEVE VENDORE TË VEPRIMIT, <https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/ligj-2022-04-14-36-P%C3%8BR-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-GRUPEVE-VENDORE-TE-VEPRIMIT.pdf>
- Republika e Shqipërisë. (2021). Ligj nr. 80/2021, dt. 24.6.2021: Për organizatat jofitimprurëse. <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2021/08/ligj-nr.-802021-dt.-24.6.2021.pdf>
- Republika e Shqipërisë. (2016) Ligj Nr. 45/2016, PËR VULLNETARIZMIN, <https://qbz.gov.al/eli/fz/2016/92/2f033324-df83-4afc-88b8-f04967bf0052;q=Ligji%20Per%20Vullnetarizmin%20>
- Republika e Shqipërisë. (2015). Ligj nr. 119/2015: Për krijimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. https://www.connectwith.eu.al/wp-content/uploads/2019/06/Dokumenta-Kombetare_-2015_Ligj_Nr.119-2015_KKSHC-AL.pdf

- Republika e Shqipërisë. (2009). Ligji nr. 10093, dt. 09.03.2009: PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE, <https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/ligj-2009-03-09-10093-1.pdf>
- Republika e Shqipërisë. (1994) Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013 https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Civill-2014_i_azhornuar-1.pdf
- USAID. (2021). *Indeksi i qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile 2021*. <https://smartbalkansproject.org/wp-content/uploads/2023/07/Indeksi-i-Qendrueshmerise-se-Organizatave-te-Shoqerise-Civile-2021.pdf>
- VENDIM Nr. 539, datë 25.7.2019, Për Miratimin e Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023”, i Rishikuar.